



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 2 (827753)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 14 Janar 2022

Merr detyrën komandanti i ri i Forcës Ajrore



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: I bindur që gjeneral brigade Pulaj do të jetë edhe më pranë problemeve

Gjeneral brigade Ylli Pulaj merr zyrtarisht detyrën e komandantit të Forcës Ajrore të FA-së. Gjeneral brigade Pulaj iu dorëzua flamuri luftarak i Forcës Ajrore nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj në një ceremoni, ku morën pjesë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e komandantë

të forcave. "Jam i bindur që gjeneral brigade Pulaj me këtë promovim do të punojë edhe më shumë edhe më mirë, do të jetë edhe më pranë problemeve edhe do t'i përballojë me sukses disa sfida që kemi përpara. Duhet të kujtojmë që pas pak ditësh fillojmë punimet zyrtarisht në bazën ajrore të Kuçovës..."

» faqe 2

Shqipëria toka e bekuar!

"Parisi i vogël", qyteti në juglindje të Shqipërisë




» faqe 5

Shqipëria do të krijojë Qendrën Kombëtare të Mbrojtjes Kibernetike

Kryeministri Rama: Sistemi i ri i mbrojtjes kibernetike, vlerë e shtuar për NATO-n

"Në kohën që jetojmë avantazhi apo shansi i vendeve më pak të zhvilluara është i panjohur në histori, i paparë dhe dëgjuar në histori, falë teknologjisë" » faqe 3



Forcat e Armatosura

Ministri Peleshi: Ti ke forcën që nderon kombin

Nën kujdesin e veçantë të ministrit të Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, i cili ka ndjekur hap pas hapi procesin e rekrutimit të të rinjve dhe të rejave për ushtarë/detarë të rinj, kjo fushatë po vazhdon në të gjithë vendin. Fushata e nisur nga Elbasani, Korça, Shkodra, Lushnja, Vlora, për të vazhduar në Durrës dhe gjithë Shqipërinë është një risi e ministrisë së Mbrojtjes, për të qenë...



» faqe 4

Kështjellat në Shqipëri

Një popull me kaq lashtësi s'mund ta harrojë kurrë historinë e tij

Ndërtime të mëdha mbrojtëse, të përbëra nga mure rrethuese të forta me kulla të larta dhe nga ndërtesa e mjedise të brendshme të nevojshme për jetesë e për t'u mbrojtur në rast lufte. Kështjellat e para në trojet shqiptare janë ngritur qysh në neolit e vonë. Njihën disa kështjella ilire si Rozafa në Shkodër, Kështjella e Beratit, Lis...

» faqe 10-11



Jens Stoltenberg

Koncepti Strategjik i NATO-s

» faqe 8-9

SPECIALE

Të drejtat e grave

"Çdo grua që kupton problemet e mbarëvajtjes së një shtëpie është shumë më afër kuptimit të problemeve të mbarëvajtjes së një vendi" (Margaret Thatcher)

» faqe 8-9

HISTORI

Dukuri të betejave të Skënderbeut

» faqe 14

Gjeneral brigade Ylli Pulaj merr zyrtarisht detyrën e komandantit të Forcës Ajrore të FA-së. Gjeneral brigade Pulajt iu dorëzua flamuri luftarak i Forcës Ajrore nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj në një ceremoni, ku morën pjesë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e komandantë të forcave.

“Jam i bindur që gjeneral brigade Pulaj me këtë promovim do të punojë edhe më shumë edhe më mirë, do të jetë edhe më pranë problemeve edhe do t’i përballojë me sukses disa sfida që kemi përpara. Duhet të kujtojmë që pas pak ditësh fillojmë punimet zyrtarisht në bazën ajrore të Kuçovës.

Forca jonë Ajrore tashmë do të operojë në një bazë taktike të rëndësishme të aleancës së NATO-s. Pas pothuajse një viti ne do të presim edhe helikopterët Black Hawk, të cilët do të jenë të parët, por jo të fundit në flotën tonë ajrore, e cila po shkon drejt modernizimit, padyshim duke u përballur me sfidën e vështirë të rritjes së gatishmërisë”, -u shpreh, gjatë fjalës së tij ministri Peleshi, duke shprehur edhe ambicien se deri në fund të vitit FAj do të jetë në gatishmërinë më të lartë që kanë pasur në vitet e fundit. “Do ta pasurojmë, do ta modernizojmë, do të rrisim kapacitet e brendshme për mirëmbajtjen dhe gatishmërinë por natyrisht do të konsolidojmë dhe një marrëdhënie të re tashmë të konkretizuar me NATO-n, me Agjencinë e Prokurimit të NATO-s, falë së cilës siç edhe e provuam, kemi një përgjigje shumë të shpejtë në mirëmbajtjen, në riparimin, në shërbimin e flotës sonë ajrore”, -theksoi ministri Peleshi. Gjeneral brigade Ylli Pulaj tha se prioritetet e punës së Forcës Ajrore do të fokusohen në: “rritjen e efikasitetit të përdorimit operacional të mjeteve ajrore; rritjen e kapaciteteve kombëtare të vëzhgimit ajror dhe përmirësimit të shkëmbimit të pamjes ajrore me strukturat përkatëse të NATO-s; rritjen e asistencës profesionale ndaj avionëve luftarakë të NATO-s, gjatë realizimit të misionit të tyre të policimit ajror, në Hapësirën Ajrore të Republikës së Shqipërisë, por edhe rritjen e profesionalizmit gjatë operacioneve, në mbështetje të popullsisë civile dhe autoriteteve shtetërore”.

Gjeneral brigade Ylli Pulaj, gjatë karrierës së tij në Forcat e Armatosura ka shërbyer në detyra të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ndërsa së fundmi mbante detyrën e zëvendëskomandantit të Forcës Ajrore.



Merr detyrën komandanti i ri i Forcës Ajrore

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: I bindur që gjeneral brigade Pulaj do të jetë edhe më pranë problemeve


“Pas pak ditësh fillojmë punimet zyrtarisht në bazën ajrore të Kuçovës”



Shqipëria do të krijojë Qendrën Kombëtare të Mbrojtjes Kibernetike

Kryeministri Rama: Sistemi i ri i mbrojtjes kibernetike, vlerë e shtuar për NATO-n

“Në kohën që jetojmë avantazhi apo shansi i vendeve më pak të zhvilluara është i panjohur në histori, i paparë dhe dëgjuar në histori, falë teknologjisë”



Kryeministri Edi Rama deklaroi se Shqipëria ka si objektiv krijimin e Qendrës Kombëtare të Mbrojtjes Kibernetike, e cila do të jetë në shërbim të ushtrisë shqiptare por do të jetë njëkohësisht edhe një vlerë e shtuar për vetë NATO-n.

Kryeministri përshëndeti firmosjen e marrëveshjes për forcimin e sigurisë kibernetike në vend dhe rritjen e infrastrukturës dixhitale, me kompaninë “Jones International” drejtuar nga James Logan Jones Jr.

Kryeministri Rama vlerësoi se kjo marrëveshje synon ngritje në një nivel tjetër të të gjithë kapaciteteve digjitale dhe sistemit të mbrojtjes kibernetike të Republikës të Shqipërisë.

Rama tha se “këtu nuk është thjesht çështja për të ndërtuar një sërë sistemesh sigurie, por për të ndërtuar një sistem tërësor sigurie që nga ana tjetër të ketë mundësi të ofrojë një vlerë të shtuar edhe për NATO-n”.

“Në kohën që jetojmë avantazhi apo shansi i vendeve më pak të zhvilluara është i panjohur në histori, i paparë dhe dëgjuar në histori, falë teknologjisë. Paradoksisht, moshzëvillimi i mjaftueshëm kthehet në avantazh dhe teknologjia në shans për të bërë kapërcime të jashtëzakonshme, siç ndodhi me transformimin tërësor në shërbimet online në Shqipëri. Kjo do të mundësojë që këtë vit ne të bëjmë një ndërhyrje radikale në sistem, duke i mbyllur të gjitha sportelet fizike dhe duke u ofruar të gjitha shërbimet online. Marrëveshja e sotme do të sigurojë edhe një bazë të dhënash të garantuar të këtyre shërbimeve”, -tha Rama.

Kryeministri vlerësoi se “sot jemi në një fazë të re të marrëdhënieve me SHBA-të dhe NATO-n”.

“Kemi disa investime të rëndësishme në infrastrukturën kritike dhe në aspektin strategjik, ku hyjnë edhe investimet në fushën e mbrojtjes dhe në këtë aspekt ne vlerësojmë shumë këtë mundësi bashkëpunimi, për të adresuar dhe sfidën e madhe të ngritjes së një Qendre Kombëtare të Mbrojtjes Kibernetike”, -tha Rama.

Kjo qendër, siç tha kryeministri, do të jetë në shërbim të ushtrisë sonë dhe gjithë aspekteve që kanë të bëjnë me pjesën civile të shoqërisë.

“Kjo është një sfidë e jashtëzakonshme, por jemi të bindur se duke pasur edhe ndihmën, mbështetjen dhe eksperiencën e kurajën tuaj, ne do t’ia dalim të kemi një Qendër Kombëtare Sigurie Kibernetike, që të jetë edhe një vlerë e shtuar për vetë NATO-n, duke dhënë shërbime edhe përtej Republikës të Shqipërisë”, -tha Rama.

Kryeministri tha se “e vlerësoj shumë aspektin e marrëveshjes sonë që ka të bëjë edhe me garancinë se kapaciteti dëmprurës i individëve do të jetë shumë më i reduktuar”. Ai tha

se një sistem i tërë i rritjes së cilësisë së burimeve njerëzore në gjithë rrjetin e njerëzve që merren me shërbime digjitale dhe mbrojtje kibernetike do të vihet në funksion.

“Po ashtu, do të ketë programe të posaçme, që eksperiencia juaj i disponon, për të siguruar se aftësia e çdo individi për të penetruar sistemin të jetë shumë e kufizuar. Sistemi do të ketë shumë mure mbrojtëse edhe nga ndërhyrja e individëve. Ky është një lajm shumë i mirë edhe për ata që u lënduan padrejtësisht nga dalja e të dhënave personale”, -tha Rama.

Kryeministri në përfundim tha se “marrëveshja e sotme” është e mirëseardhur për qytetarët duke iu referuar zhvillimeve të fundit. “Jam i bindur se e shikojnë me lehtësim përfshirjen tuaj personale në këtë përpjekje të qeverisë shqiptare. Ju falënderoj për besimin e kurajën që na jepni dhe falënderoj ekipin tuaj që ka dëshmuar vlerën e dobisë e tij në asistencën që na ka dhënë për të qenë të mbrojtur në sistemet tona kritike të energjisë. Tani të bëjmë së bashku që në pak vite, ne të jemi krenarë për sistemin e mbrojtjes kibernetike që kemi si një vend që po zhvillohet me shpejtësi në aspektin e teknologjisë, por edhe vend i vogël por dinjitoz i NATO-s”, -tha z. Rama, duke iu drejtuar James Logan Jones Jr.





Forcat e Armatosura

Ti ke forcën që nderon kombin

Ministri Peleshi: Të gjithë ata të rinj që do të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura, si rezultat i këtij procesi rekrutimi, do të vlerësohen nga një sistem pagash që është ndër më të lartat në rajon

Nën kujdesin e veçantë të ministrit të Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, i cili ka ndjekur hap pas hapi procesin e rekrutimit të rinjve dhe të rejave për ushtarë/detarë të rinj, kjo fushatë po vazhdon në të gjithë vendin. Fushata e nisur nga Elbasani, Korça, Shkodra, Lushnja, Vlora, për të vazhduar në Durrës dhe gjithë Shqipërinë është një risi e ministrisë së Mbrojtjes, për të qenë më pranë të rinjve dhe për të hapur një derë që për shumë prej tyre ka qenë një ëndërr.

Mes tyre ministri Peleshi u shpreh: Pagë mujore dinjitoze si asnjëherë më parë, përgatitje fizike dhe profesionale e vazhdueshme brenda dhe jashtë vendit sipas standardeve të NATO-s dhe përfitime të tjera për një karrierë të sigurt. Qeveria shqiptare e bën këtë për t'i treguar Aleancës se Shqipëria meriton të jetë anëtare e NATO-s, por edhe për të treguar ambicien për të qenë të krahasueshëm me vendet e tjera anëtare të kësaj aleance.

Rreth 400 vende të lira janë sot pranë FA-ve, për ushtarë dhe detarë aktivë. Për të gjithë të rinjtë apo të rejtat nga 18 deri në 27 vjeç.

Zgjidh një karrierë profesionale pranë Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe ndero kombin.

REGJISTROHU TANI DHE BËHU PJESË E FORCAVE TË ARMATOSURA.



Shqipëria toka e bekuar!

“Parisi i vogël”, qyteti në juglindje të Shqipërisë

Një qytet i pasur me vlera, tradita, zakone, pasuri mbresëlënëse natyrore, për të mos lënë pas dhe kulturën. Korça mbetet një ndër qytetet model në Shqipëri

“Parisi i vogël”, qyteti i serenatave, djep i kulturës, i shtruar me rrugicat e kall-drëmta. Ka dhjetëra epitete për këtë qytet, për të përshkruar mrekullitë e tij. Një qytet i pasur me vlera, tradita, zakone, pasuri mbresëlënëse natyrore, për të mos lënë pas dhe kulturën. Korça mbetet një ndër qytetet model në Shqipëri. E ndodhur në juglindje të vendit, ky qytet cilësohet si më i bukur në vend.

Ndonëse qyteti i Korçës është themeluar në shekujt V-VI, zona e Korçës e ndodhur në truallin historik të ilirëve është banuar që nga mijëvjeçari i katërt p.e.s. Gërmimet kanë nxjerrë në dritë varre dhe fortifikime ilire. Deri në vitin 650 p.e.s. fushëgropa e Korçës udhëhiqej nga një dinasti e Mbretërisë ilire, ndërkohë pas këtij viti u udhëhoq nga një dinasti Kaone. Gjatë kësaj periudhe, zona banohej më së shumti nga fise Kaone dhe Molose. Krahina e Korçës ra nën sundimin e perandorit bullgar Boriz në vitin 853. Ai formoi në këtë zonë njësinë administrative të emërtuar “Kutmicevicë”, që në shqip do të thotë “Tokë e porsa pushtuar”. Forcat bullgare qëndruan këtu deri në vitin 1018.

Në vitin 1440, zona e Korçës u pushtua nga osmanët. Ndërkohë që qyteti modern i Korçës u formua në shekullin XV, kur Iljaz bej Mirahori e zhvilloi Korçën sipas urdhrat të Sulltan Mehmetit II. Nën pushtimin osman, Korça njihet me emrin “Göricë” dhe ishte sanxhak i vilajetit të Manastirit. Por xhamia ishte ndërtimi i parë i Iljaz bej Mirahorit, sepse përreth lulëzoi Pazari i vjetër i Korçës. Qyteti nisi të lulëzojë pas bastisjes së Voskopojës nga osmanët në vitin 1788. Ndërmjet viteve 1769-1789 në Korçë erdhën shumë familje voskopojare, të cilat i dhanë qytetit pak nga lavdia e Voskopojës. Në vitin 1783 qyteti u bë pjesë e Pashallëkut të Ali pashë Tepelenës. Gjatë shekullit XIX dhe fillim shekullit XX Korça u bë qendër e rëndësishme e Rilindjes Kombëtare. Kështu në vitin 1887 u hap shkolla e parë fillore në gjuhë shqipe nga Organizata Drita, ndërsa po në Korçë, në vitin 1891 u hap shkolla e parë për vajza nga familja Qirjazi. Në vitin 1968 ndërtesa u kthye në Muzeun e Arsimit.

Korça përbën një nga qendrat kulturore më të rëndësishme të Shqipërisë. Vetë muzetë e shumta në qytet përshkruajnë aktivitetin kulturor ndër shekuj. Në këtë qytet është shkolla e parë shqipe, e cila daton në vitin 1887, shkolla e parë në Shqipëri për vajza, si dhe liceu Francez i ndërtuar në vitin 1917. Edhe pse ndër vite qyteti ka qenë pushtuar disa herë, ndikimet e huaja përbëjnë një pjesë të vogël të kulturës korçare.

Korça ka tradita dhe zakone të veçanta, gjë që dëshmon se qyteti ka qenë një vatër e rëndësishme e kul-



turës me shumëllojshmëri materiale shpirtërore për popullin shqiptar. Dy nga veprat më të rëndësishme të folklorit shqiptar janë “Bleta Shqiptare” e Thimi Mitkos dhe “Valët e Detit” e Spiro Dines.

Çdo qytet dhe krahinë në shekuj ka krijuar kulturën e vet. Kështu dhe populli i Korçës ka krijuar gojëdhëna, përralla, gjëgjëza, këngë, fjalë të urta të njohura në të gjithë vendin. Për to janë kryer studime dhe botime të ndryshme, që janë bërë të njohura e të dashura për shpirtin e shqiptarit dhe të korçarit.

Sa i përket veshjeve tradicionale, fustanellat, kallat dhe opingat me xhufka të zeza, karakterizojnë veshjen e një burri, ku nuk mungonte dhe fesi me ngjyrë të bardhë në kokë. Ndërsa karakteristike për veshjen e grave ishte xhamadani dhe shamia e bardhë në kokë.

I njohur si një nga qytetet më të pasura me monumente kulture, Korça

numëron rreth 110 të tillë, të cilët mbrohen nga shteti. Kjo dëshmon se qyteti në të kaluarën ka qenë vatër kryesore e kulturës materiale e shpirtërore. Muzeu i artit mesjetar shqiptar është i vetmi i këtij lloji në Shqipëri. Ai përmban objekte me vlera artistike e shpirtërore që shkojnë deri në periudhën e Mesjetës. Në të ndodhen vepra të piktorëve të shquar shqiptarë si: Onufri, i biri i tij Nikolla, vëllezërit Athanas Zografi, Kostandin Jeronaku nga Voskopoja, e shumë të tjerë. Vlen të përmendet këtu Muzeu Arkeologjik i Korçës si dhe Muzeu i Arsimit Korça, përpos serenatave dhe këngëve

të dashurisë që janë shpirti i qytetit, të ofron edhe një sërë alternativash për të vizituar.

Eventet e ndryshme apo vizitat në pesë muzetë e qytetit janë një alternativë për ata që preferojnë turizmin kulturor. Katedralja Ringjallja e Krishtit në Ko-

rcë është një tjetër atraksion turistik, brenda qytetit. Një katedrale që për nga përmasat cilësohet si më e rëndësishmja në Korçë dhe më e madhja në Shqipëri. Ndërkohë i restauruar vitet e fundit, Pazari i Vjetër i Korçës është bërë qendra e vizitorëve të huaj dhe vendas. Ai mbetet një nga objektet me vlera të hershme historike, kulturore dhe artistike.

Atraksionet turistike me vlera të paçmuara që e pasurojnë edhe më shumë Korçën janë edhe fshatrat turistikë me natyrën e tyre piktoreske, ku vlen të përmenden Boboshtica, Dardha apo Voskopoja, ku turizmi familjar dhe temperaturat e freskëta i bëjnë këto fshatra të preferuara. Ndërkohë që sportet dimërore, sidomos skitë, tërheqin turistë të apasionuar pas tyre. Vetëm 20 minuta larg qytetit të Korçës ndodhet Parku Kombëtar i Prespës, një nga parqet natyrore më të mëdhenj dhe impresionues të Shqipërisë që ia vlen të vizitohet, pa lënë mënjane dhe dy liqenet e mrekullueshëm të Prespës së Madhe dhe Prespës së Vogël, të cilët prej pesë milion vitesh i bëjnë shoqëri njëri-tjetrit.

Arti i kulinarisë në Korçë është një arsye më shumë për ta vizituar këtë qytet. Gatimi i shpendëve dhe kafshëve të egra është kënaqësi më vete që duhet provuar. Parajsa e juglindjes së Shqipërisë të ofron në të katër stinët e vitit mirazhet e ëndrrave të bukura.

Bukuritë shqiptare, një atraksion që duhet shijuar!



MSC. MIMOZA GOLIKJA

(..vijon nga numri i kaluar)

NATO njofton, në faqen zyrtare, se do të miratojë Konceptin e saj të ri Strategjik në Samitin e Madridit 2022. Ky koncept do të përcaktojë sfidat e sigurisë me të cilat përballet Aleanca dhe do të përshkruajë detyrat politike dhe ushtarake që NATO do të kryejë për t'i trajtuar ato.

Hakmarrja masive dhe Koncepti i tretë Strategjik i NATO-s

Puna e “Grupit të Qasjes së Re”, e kombinuar me parashtrësia të tjera solli “Modelin më efektiv të forcës ushtarake të NATO-s për pesë vitet e ardhshme” (MC 48), miratuar nga Komiteti Ushtarak, më 22 nëntor 1954 dhe nga NAC, më 17 dhjetor 1954. Ai dha udhëzime strategjike në pritje të rishikimit të MC 14/1 dhe përmbante koncepte dhe supozime që u përfshinë më vonë në konceptin e tretë strategjik të NATO-s.

MC 48 ishte dokumenti i parë zyrtar i NATO-s që diskutoi në mënyrë eksplícite përdorimin e armëve bërthamore. Ai prezantoi konceptin e hakmarrjes masive, i cili normalisht lidhet me MC 14/2, Koncepti i tretë Strategjik i NATO-s.

Pas një diskutimi të konsiderueshëm, MC 14/2, “Koncepti i përgjithshëm strategjik për mbrojtjen e zonës së NATO-s” doli në formën e tij përfundimtare më 23 maj 1957 dhe u shoqërua me MC 48/2, “Masat për zbatimin e konceptit strategjik”, mbi të njëjtën ditë. MC 14/2 ishte Koncepti i parë Strategjik i Aleancës, i cili mbrojti “hakmarrjen masive” si një element kyç të strategjisë së re të NATO-s.

Ndërsa disa aleatë mbështetën fuqimisht hakmarrjen masive pasi ajo kishte avantazhin e ndihmës për të reduktuar kërkesat për forcë dhe, për rrjedhojë, shpenzimet e mbrojtjes, jo të gjitha vendet anëtare donin të shkonin kaq larg. Një shkallë fleksibiliteti u prezantua në kuptimin që përdorimi i armëve konvencionale ishte parashikuar për t'u marrë me forma të caktuara, më të vogla të agresionit, pa pasur domosdoshmëri rekurs ndaj armëve bërthamore. Kjo u reflektua edhe në udhëzimin strategjik shoqëruar. Pavarësisht nga ky fleksibilitet, megjithatë u deklarua se NATO nuk e pranonte konceptin e luftës së kufizuar me BRSS: “Nëse sovjetikët do të përfshiheshin në një veprim armiqësor lokal dhe do të kërkonin të zgjeronin shtrirjen e një incidenti të tillë ose ta zgjasnin atë, situata do të bëjë thirrje për përdorimin e të gjitha armëve dhe forcave që ka në dispozicion të NATO-s, pasi në asnjë rast nuk ekziston një koncept i luftës së kufizuar me sovjetikët”.

Përveç përfshirjes së doktrinës së “hakmarrjes masive”, MC 14/2 dhe MC 48/2 pasqyruan shqetësime të tjera duke përfshirë efektet në Aleancën e aktiviteteve politike dhe ekonomike sovjetike jashtë zonës së NATO-s. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e krizës së Suezit dhe shtypjes së kryengritjes hungareze nga Bashkimi Sovjetik në 1956. Rëndësia e ngjarjeve jashtë zonës u pasqyrua në një direktivë politike, CM(56)138, dhënë

Jens Stoltenberg: Koncepti Strategjik i Madridit do të pasqyrojë mjedisin e ri të sigurisë, do të ripërkushtohet ndaj vlerave tona dhe do të riafirmojë unitetin tonë, duke siguruar që Aleanca jonë të jetë e përshtatshme për të ardhmen



nga NAC për Autoritetet Ushtarake të NATO-s, 13 dhjetor 1956: “Megjithëse planifikimi i mbrojtjes i NATO-s është i kufizuar në mbrojtjen e zonës së Traktatit, është e nevojshme të merren parasysh rreziqet që mund të shfaqen për NATO-n për shkak të zhvillimeve jashtë asaj zone.Ë

Raporti i Tre Burrave të Mençur

Ndërkohë që NATO po forconte qëndrimin e saj ushtarak dhe strategjik, paralelisht vendosi të përforconte rolin politik të Aleancës. Pak muaj para miratimit të MC 14/2, në dhjetor 1956, ajo publikoi Raportin e Komitetit të Treshëve ose Raportin mbi Bashkëpunimin Jo-Ushtarak në NATO.

Ky raport, i hartuar nga tre ministra të jashtëm të NATO-s - Lester Pearson (Kanada), Gaetano Martino (Itali) dhe Halvard Lange (Norvegji) - i dha shtysë të re konsultimit politik midis vendeve anëtare për të gjitha aspektet e marrëdhënieve midis Lindjes dhe Perëndimit.

Raporti u miratua në mes të krizës së Suezit, kur konsultimi i brendshëm për çështjet e sigurisë që prekin Aleancën ishte veçanërisht i ulët, duke rrezikuar solidaritetin e Aleancës. Kjo ishte hera e parë që nga nënshkrimi i Traktatit të Uashingtonit që NATO kishte njohur zyrtarisht nevojën për të përfunduar rolin e saj politik. Raporti parashtronte disa rekomandime, duke përfshirë zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërmjet anëtarëve, bashkëpunimin ekonomik, bashkëpunimin shkencor dhe teknik, bashkëpunimin kulturor dhe bashkëpunimin në fushën e informacionit.

Hakmarrja masive e vënë në pikëpyetje

Sapo u miratua Koncepti i tretë Strategjik i NATO-s, ndodhën një sërë

zhvillimesh ndërkombëtare që vënë në pikëpyetje strategjinë e Aleancës për hakmarrje masive.

Kjo strategji mbështetej shumë në aftësinë bërthamore të Shteteve të Bashkuara dhe vullnetin e tyre për të mbrojtur territorin evropian në rastin e një sulmi bërthamor sovjetik. Së pari, europianët filluan të dyshojnë nëse një president i SHBA-së do të sakrifikonte një qytet amerikan për një qytet evropian; së dyti, BRSS kishte zhvilluar aftësi raketore balistike ndërkontinentale dhe, në përgjithësi, aftësinë e saj bërthamore. Me rritjen e potencialit bërthamor të BRSS, avantazhi konkurrues i NATO-s në parandalimin bërthamor u zvogëluar. Filluan të përdoren terma të tillë si “Shkatërrimi i Siguruar Reciprokisht ose MAD”.

Shpërthimi i krizës së dytë të Berlinit (1958-1962), i provokuar nga Bashkimi Sovjetik, përforcoi këto dyshime: si duhet të reagojë NATO ndaj kërcënimeve që ishin në nivelin e një sulmi të gjithanshëm? Parandalimi bërthamor i NATO-s nuk i kishte ndaluar sovjetikët të kërcënonin pozicionin e aleatëve perëndimorë në Berlin. Pra, çfarë duhet bërë?

Në vitin 1961, J.F. Kenedy mbërriti në Shtëpinë e Bardhë. Ai ishte i shqetësuar nga çështja e luftës së kufizuar dhe nocioni se një shkëmbim bërthamor mund të fillonte aksidentalisht ose gabimisht. Ndërkohë, kriza e Berlinit u intensifikua, duke çuar në ndërtimin e Murit të Berlinit dhe në tetor 1962, Lufta e Ftohtë arriti kulmin me krizën e raketave Kubane.

Shtetet e Bashkuara filluan të mbrojnë një qëndrim më të fortë jobërthamor për NATO-n dhe nevojën për një strategji të “përgjigjes fleksibël”. Diskutimet fillestare për ndryshimin e strategjisë u nisën midis vendeve anëtare të NATO-s,



por nuk pati konsensus.

Koncepti i katërt strategjik i NATO-s dhe doktrina e reagimit fleksibël

Koncepti i katërt strategjik i NATO-s, Koncepti i përgjithshëm strategjik për mbrojtjen e zonës së Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (MC 14/3), u miratua nga Komiteti i Planifikimit të Mbrojtjes (DPC), më 12 dhjetor 1967, dhe versioni përfundimtar i lëshuar më 16 janar 1968. u hartua pas tërheqjes së Francës nga struktura e integruar ushtarake e NATO-s në vitin 1966.

Kishte dy karakteristika kryesore të strategjisë së re: Fleksibiliteti dhe Përshkallëzimi. “Koncepti parandalues i Aleancës bazohet në një fleksibilitet që do të pengojë agresorin e mundshëm të parashikojë me besim përgjigjen specifike të NATO-s ndaj agresionit dhe që do ta çojë atë në përfundimin se një shkallë e papranueshme rreziku do të përfshihej pavarësisht nga natyra e sulmit të tij.” Ai identifikoi tre lloje të përgjigjeve ushtarake kundër agresionit ndaj NATO-s: Mbrojtja e drejtpërdrejtë: qëllimi ishte mposhtja e agresionit në nivelin në të cilin armiku zgjodhi të luftonte. Përshkallëzimi i qëllimshëm: kjo shtoi një sërë hapash të mundshëm për të mposhtur agresionin duke rritur në mënyrë progresive kërcënimin e përdorimit të energjisë bërthamore ndërsa kriza u përshkallëzua. Përgjigja e përgjithshme bërthamore: e parë si parandalimi përfundimtar. Dokumenti shoqëruar, “Masat për Zbatimin e Konceptit Strategjik për Mbrojtjen e Zonës së NATO-s (MC 48/3) u miratua nga DPC më 4 dhjetor 1969 dhe u lëshua në formën përfundimtare më 8 dhjetor 1969. Si MC 14/3 ashtu edhe MC 48/3 ishin kaq elastike, në thelb dhe interpretim, saqë mbetën të vlefshme deri në fund të Luftës së Ftohtë.

Raporti Harmel

Ndërsa NATO po përcaktonte objektivat e saj strategjike për 20 vitet e ardhshme, ajo gjithashtu vendosi të hartonte një raport që ofronte një qasje të dyfishtë për sigurinë politike

dhe ushtarake. Në kuadër të vënies në pikëpyetje, nga disa, të rëndësishme të NATO-s, u hartua “Raporti Harmel” ose “Raporti mbi Detyrat e Ardhsme të Aleancës”. Ai ofroi një analizë të gjerë të mjedisit të sigurisë që nga nënshkrimi i Traktatit të Atlantikut të Veriut në 1949 dhe mbrojti nevojën për të ruajtur mbrojtjen adekuate duke kërkuar një relaksim të tensioneve në marrëdhëniet Lindje-Perëndim dhe duke punuar drejt zgjidhjeve të problemeve themelore politike që ndajnë Evropën.

Ai përcaktoi dy detyra specifike: politike dhe ushtarake; politike, me formulimin e propozimeve për reduktimin e balancuar të forcave në Lindje dhe Perëndim; ushtarake, me mbrojtjen e zonave të ekspozuara, veçanërisht të Mesdheut.

Raporti Harmel prezantoi nocionin e parandalimit dhe detentimit. Në këtë aspekt, siç u tha tashmë në kontekstin e Raportit të Burrave të Mençur, ai vendosi tonin për hapat e parë të NATO-s drejt një qasjeje më bashkëpunuese ndaj çështjeve të sigurisë që do të shfaqeshin në vitin 1991.

Megjithatë, mes viteve 1967 dhe 1991, kishte ende momente tensioni të madh mes dy blloqeve, pasi kishte raste që lindnin shpresa për një marrëdhënie më pak të trazuar. Tensionet u rritën me pushtimin sovjetik të Afganistanit dhe vendosjen e raketave sovjetike SS-20 ndaj të cilave NATO reagoi duke iniciuar Vendimin e saj të Dyfishtë, dhjetor 1979: ajo i ofroi Paktit të Varshavës një kufizim të ndërsjellë të raketave balistike me rreze të mesme dhe të ndërmjetme veprimi dhe, duke mos marrë një reagim pozitiv nga Moska, kjo gjë solli më pas kërcënimin për vendosjen e raketave Pershing dhe Kruz, gjë që përfundimisht ndodhi.

Zbutja u rrit me nënshkrimin e marrëveshjeve SHBA-Sovjetike për Kufizimet e Armëve Strategjike (SALT I) dhe sistemet e raketave antibalistike, dhe SALT II (megjithëse e pa ratifikuar), si dhe nënshkrimin e bisedimeve SHBA-Sovjetike për Reduktimin e Armëve Strategjike (START) dhe Traktatit të Forcave Bërthamore me rreze të ndërmjetme veprimi (INF).

Nga mesi deri në fund të viteve

80, të dy blloqet kaluan në ndër-timin e besimit. Megjithatë, mosbesimi i ndërsjellë karakterizonte ende marrëdhëniet Lindje-Perëndim dhe vetëm nga rënia e Murit të Berlinit, shpërbërja e Paktit të Varshavës dhe shpërbërja e Bashkimit Sovjetik, marrëdhëniet, mund të fillonin në një bazë të re.

Periudha e menjëhershme e pas Luftës së Ftohtë

Në vitin 1991 filloi një epokë e re. Armiku i frikshëm që dikur kishte qenë Bashkimi Sovjetik u shpërbë dhe Rusia, së bashku me ish-kundërshtarët e tjerë, u bënë partnerë të NATO-s dhe, në disa raste, anëtarë të NATO-s. Për Aleancën, periudha u karakterizua nga dialogu dhe bashkëpunimi, si dhe mënyra të tjera të reja për të kontribuar për paqen dhe stabilitetin, siç janë operacionet shumëkombëshe të menaxhimit të krizave.

Gjatë periudhës së menjëhershme të pas Luftës së Ftohtë, NATO nxori dy Koncepte Strategjike të paklasifikuara që mbronin një qasje më të gjerë ndaj sigurisë së më parë: Koncepti Strategjik i Aleancës, Nëntor 1991; Koncepti Strategjik i Aleancës, Prill 1999.

Të dyja këto shoqëroheshin nga një dokument ushtarak i klasifikuar: përkatësisht MC 400 dhe MC 400/2.

Koncepti i parë strategjik i paklasifikuar i NATO-s

Koncepti Strategjik i vitit 1991 ndryshonte në mënyrë dramatike nga dokumentet e mëparshme strategjike. Së pari, ishte një dokument jo konfrontues që u publikua; dhe së dyti, duke ruajtur sigurinë e anëtarëve të saj si qëllimin e saj themelor (d.m.th. mbrojtjen kolektive), ajo u përpoq të përmirësonte dhe zgjeronte sigurinë për Europën në tërësi përmes partneritetit dhe bashkëpunimit me ish-kundërshtarët. Ai gjithashtu uli përdorimin e forcave bërthamore në një nivel minimal, të mjaftueshëm për të ruajtur paqen dhe stabilitetin: “Ky Koncept Strategjik ripohon natyrën mbrojtëse të Aleancës dhe vendosmërinë e anëtarëve të saj për të mbrojtur sigurinë, sovranitetin dhe integritetin e tyre territorial. Politika e sigurisë e Aleancës bazohet në dialog; bashkëpunim dhe mbrojtje kolektive efektive si instrumente reciproke përforcuese për ruajtjen e paqes. Duke shfrytëzuar plotësisht mundësitë e reja të disponueshme, Aleanca do të ruajë sigurinë në nivelin më të ulët të mundshëm të forcave në përputhje me kërkesat e mbrojtjes. Në këtë mënyrë, Aleanca po jep një kontribut thelbësor në promovimin e një rendi paqësor të qëndrueshëm.” Dokumenti shoqëruet i Konceptit Strategjik të vitit 1991 ishte dhe ende është i klasifikuar. Ajo titullohet: “Direktiva MC për Zbatimin Ushtarak të Konceptit Strategjik të Aleancës (MC 400)”, 12 dhjetor 1991.

Koncepti i dytë strategjik i paklasifikuar i NATO-s

Në vitin 1999, në vitin e 50-vjetorit të NATO-s, Udhëheqësit Aleatë miratuan një Koncept të ri Strategjik që angazhoi anëtarët për mbrojtjen e përbashkët dhe paqen dhe stabilitetin e zonës më të gjerë Euro-Atlantike. Ai bazohej në një përkufizim të gjerë

“Javë e rëndësishme për sigurinë europiane”

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s priti zëvendëskryeministren e Ukrainës për Integrimin European dhe Euro-Atlantik, në Bruksel

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg priti zëvendëskryeministren e Ukrainës për Integrimin European dhe Euro-Atlantik, Olga Stefanishyna, në selinë e NATO-s, më 10 janar 2022, për takimin e Komisionit NATO-Ukrainë, i fokusuar në grumbullimin e vazhdueshëm ushtarak të Rosisë.

Duke e quajtur Ukrainën “një partner të vlerësuar dhe afatgjatë” me të drejtën për të zgjedhur rrugën e vet, Sekretari i Përgjithshëm vuri në dukje se takimi i sotëm shënon fillimin e një jave të rëndësishme për sigurinë europiane, e cila përfshin takimin e Këshillit NATO-Rusi, më 12 janar, bisedimet dypalëshe midis Shteteve të Bashkuara dhe Rosisë dhe një takim i OSBE-së.

Z. Stoltenberg e quajti Komisionin NATO-Ukrainë një mundësi për të shkëmbyer vlerësime mbi situatën; për të shprehur mbështetjen e fortë të aleatëve për Ukrainën; dhe për të koordinuar përpara angazhimeve diplomatike me Moskën.

Sekretari i Përgjithshëm, Stoltenberg njoftoi mediet mbi takimin, në konferencën e përbashkët të shtypit që dha me zëvendëskryeministren për Integrimin European dhe Euro-Atlantik të Ukrainës, Olga Stefanishyna.

“Sapo patëm një takim shumë të mirë dhe më pas do të vazhdojmë më vonë me një takim me të 30 aleatët e NATO-s në Komisionin NATO-Ukrainë më vonë sot. Ne sapo trajtuam situatën në zhvillim në dhe rreth Ukrainës. Grumbullimi ushtarak i Rosisë vazhdon, me dhjetëra mijëra trupa të gatshme luftarake, të armatosur me aftësi të rënda. Të premtën, ministrat e jashtëm të NATO-s i bënë sërish thirrje Rosisë që të largojë forcat e saj nga Ukraina dhe nga kufijtë tuaj. Të demonstrojë transparencë dhe të de-përshkallëzojë. Çdo agresion i mëtejshëm kundër Ukrainës do të kishte një çmim të lartë politik dhe ekonomik.

Aleatët e NATO-s janë të bashkuar në mbështetjen e tyre që të gjitha kombet të zgjedhin rrugën e tyre. Ky ka qenë një parim themelor i sigurisë evropiane për dekada.

Ukraina është një partner i vlerësuar dhe afatgjatë i NATO-s dhe takimi i sotëm i Komisionit NATO-Ukrainë vjen në fillimin e një jave të rëndësishme për sigurinë europiane. Shtetet e Bashkuara dhe Rusia po takohen aktualisht në Gjenevë. Të mërkurën do të mbajmë takimin



e Këshillit NATO-Rusi këtu në Bruksel dhe të enjten takimi në OSBE.

Takimi ynë në Komisionin NATO-Ukrainë është një mundësi në kohë për të shkëmbyer vlerësime mbi situatën. Për të shprehur mbështetjen e fortë politike dhe praktike të aleatëve për Ukrainën dhe për të koordinuar përpara angazhimeve diplomatike me Rusinë.

E mirëpres që Rusia ka rënë dakord me ofertën tonë për të mbajtur një takim të Këshillit NATO-Rusi më vonë këtë javë. Ky është një sinjal pozitiv.

Ne do të fokusohemi në çështjet e sigurisë evropiane, transparencën në lidhje me aktivitetet ushtarake, reduktimin e rrezikut dhe kontrollin e armëve. Ne do të dëgjojmë shqetësimet e Rosisë, por çdo dialog kuptimplotë duhet të adresojë gjithashtu shqetësimet tona për veprimet e Rosisë dhe duhet të bëhen në konsultim me Ukrainën, siç po bëjmë sot. Ne jemi gjithashtu duke u konsultuar ngushtë me partnerë të tjerë, përfshirë Gjeorgjinë, Moldavinë, Finlandën, Suedinë dhe Bashkimin Evropian”, -përfundon deklarata e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s.

të sigurisë, i cili njohu rëndësinë e faktorëve politikë, ekonomikë, socialë dhe mjedisorë përveç dimensionit të mbrojtjes. Ai identifikoi rreziqet e reja që ishin shfaqur që nga fundi i Luftës së Ftohtë, të cilat përfshinin terrorizmin, konfliktin etnik, abuzimet e të drejtave të njeriut, paqëndrueshmërinë politike, brishtësinë ekonomike dhe përhapjen e armëve bërthamore, biologjike dhe kimike dhe mjetet e shpërndarjes së tyre.

Dokumenti thoshte se detyrat themelore të Aleancës ishin siguria, konsultimi dhe parandalimi dhe mbrojtja, duke shtuar se menaxhimi i krizës dhe partneriteti ishin gjithashtu thelbësorë për rritjen e sigurisë dhe stabilitetin në zonën euro-atlantike. Ai vuri në dukje se NATO kishte arritur të përshtatej dhe të luante një rol të rëndësishëm në mjedisin e pas Luftës së Ftohtë dhe kishte vendosur udhëzime për forcat e Aleancës, duke i përkthyer qëllimet dhe detyrat e seksioneve të mëparshme në udhëzime praktike për forcat e NATO-s dhe planifikuesit operacionalë. Strategjia kërkonte zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive ushtarake të nevojshme për gamën e plotë të misioneve të Aleancës, nga mbrojtja kolektive deri të mbështetja e paqes dhe operacionet e tjera të reagimit

ndaj krizave. Ai gjithashtu përcaktoi se Aleanca do të ruante për të ardhmen e parashikueshme një përzjerje të përshtatshme të forcave bërthamore dhe konvencionale.

Koncepti Strategjik i vitit 1999 u plotësua nga një dokument udhëzues strategjik që mbetet i klasifikuar: “Udhëzimi MC për Zbatimin Ushtarak të Strategjisë së Aleancës” (MC 400/2), 12 shkurt 2003.

Mjedisi i sigurisë që nga 11 shtatori

Sulmet terroriste të 11 shtatorit në 2001 kundër Shteteve të Bashkuara sollën në plan të parë kërcënimin e terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë. NATO-s i duhej të mbronte popullsinë e saj si brenda dhe jashtë vendit. Prandaj, ajo iu nënshtrua reformave të brendshme të mëdha për të përshtatur strukturat dhe aftësitë ushtarake për të pajisur anëtarët për detyra të reja, të tilla si drejtimi i Forcës Ndërkombëtare të Asistencës për Sigurinë (ISAF) të mandaturuar nga OKB-ja në Afganistan.

Në nëntor 2006 Udhëheqësit e NATO-s miratuan “Udhëzimin Gjithëpërfshirës Politik”. Ky është dokumenti kryesor i politikave që përcakton kuadrin dhe prioritetet për të gjitha

çështjet e aftësive të Aleancës, disiplinat e planifikimit dhe inteligjencën për 10 deri në 15 vitet e ardhshme. Ai analizoi mjedisin e mundshëm të sigurisë në të ardhmen dhe pranoi mundësinë e ngjarjeve të paparashikueshme. Kundrejt asaj analize, ajo përcakton llojet e operacioneve që Aleanca duhet të jetë në gjendje të kryejë në dritën e Konceptit Strategjik të Aleancës dhe llojet e aftësive që i nevojiten NATO-s.

Më vonë, në Samitin Strasburg-Kehl në prill 2009, udhëheqësit e NATO-s miratuan “Deklaratën për Sigurinë e Aleancës”, e cila, ndër të tjera, bëri thirrje për një Koncept të ri Strategjik. Kjo provokoi një debat dhe analizë të plotë të çështjeve të NATO-s dhe, së bashku me kontekstin ekonomik, paraqiti një mundësi për rimendim, ripërcaktim dhe reformim të NATO-s.

Koncepti i tretë strategjik i paklasifikuar i NATO-s

Koncepti aktual Strategjik, i nxjerrë në Samitin e Lisbonës në nëntor 2010, shoqërohet nga Udhëzuesi i Komitetit Ushtarak MC 400/3, mars 2012. Ai ripohon vlerat dhe qëllimin e NATO-s dhe silltet rreth tre detyrave thelbësore, mbrojtja kolektive, menaxhimi i krizave

dhe siguria bashkëpunuese. Ai siguron një vlerësim kolektiv të mjedisit të sigurisë në atë kohë, nxiti përshtatjen strategjike të NATO-s dhe udhëhoqi zhvillimin e saj politik dhe ushtarak për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Por, që nga viti 2010 bota ka ndryshuar rrënjësisht. Konkurrenca strategjike po rritet. NATO-s do t'i duhet të përgatitet për një botë më konkurruese dhe më të paqëndrueshme. Koncepti i ri Strategjik do të jetë një mundësi për të nënvizuar unitetin e NATO-s dhe për t'u ripërkushtuar ndaj vlerave të saj, dhe për të vlerësuar përshtatjen e rëndësishme ushtarake dhe politike të NATO-s që nga viti 2014. Ajo do të duhet gjithashtu të trajtojë një Rusi më agresive në kufijtë e NATO-s dhe ngritjen e Kinës, si dhe teknologjitë në zhvillim dhe shkatërruese dhe ndikimi i ndryshimeve klimatike në siguri.

Koncepti i ri Strategjik i NATO-s do të bazohet në ato elemente të Konceptit Strategjik të NATO-s të vitit 2010 që mbeten të vlefshme deri më sot, si dhe në vendimet e marra nga aleatët e NATO-s në Samitin e Brukselit në qershor 2021, në veçanti rekomandimet nga axhenda e NATO-s 2030. Koncepti i ri Strategjik i NATO-s do të miratohet në Samitin e Madridit në qershor 2022.

Punoi: Anjeza Musollari
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Çdo grua që kupton problemet e mbarëvajtjes së një shtëpie është shumë më afër kuptimit të problemeve të mbarëvajtjes së një vendi”
(Margaret Thatcher)

Të drejtat e grave

Të drejtat e grave janë të drejtat themelore të njeriut, të cilat u ruajtën nga Kombet e Bashkuara për çdo qenie njerëzore në planet rreth 70 vjet më parë. Këto të drejta përfshijnë të drejtën për të jetuar pa dhunë, skllavëri dhe diskriminim; të arsimohen; të posedojnë pronën e tyre; të drejtën për të votuar; dhe për të fituar një pagë të drejtë dhe të barabartë. Megjithatë pothuajse kudo në botë, grave dhe vajzave ende u mohohen të drejtat, shpesh thjeshtë për shkak të gjinisë së tyre. Të drejtat fitimtare për gratë janë më shumë sesa dhënia e mundësive për çdo grua ose vajzë individuale; po ashtu po ndryshon se si punojnë vendet dhe komunitetet. Ai përfshin ndryshimin e ligjeve dhe politikave, duke fituar zemrat dhe mendjet, dhe duke investuar në organizata dhe lëvizje të fuqishme të grave. Gratë kanë qenë të detyruara që për një kohë të gjatë të luftojnë për njohjen dhe pranimin e tyre si qenie të plota njerëzore dhe pranimin e të drejtave të tyre themelore, por fatkeqësisht, kjo luftë vazhdon edhe sot.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk janë vetëm të drejta njerëzore, ato janë gjithashtu të domosdoshme edhe për arritjen e një zhvillimi përfshirës, të barabartë dhe të qëndrueshëm. Trajtimi i grave nga ana e shoqërisë, e cila në shumë vende/ shoqëri ka qenë e organizuar dhe e dominuar nga burrat, nënkuptonte se gratë nuk gëzonin të drejta të barabarta me burrat në shumë sfera të ndryshme të jetës. Rrethanat e tilla si Luftërat Botërore nënkuptonin se roli i grave shihej përmes një perspektive të ndryshme, dhe jo vetëm lindja e fëmijëve dhe të qenit amvisë. Gjatë luftërave, gratë në tërë botën kanë kontribuar në mënyra të ndryshme. Në shumë pjesë të Evropës, si në Britaninë e Madhe, pozita e grave në shoqëri ka ndryshuar në mënyrë drastike, si rezultat i luftërave. Një feministe udhëheqëse në Angli, znj. Millicent Fawcett, kishte thënë se “lufta kishte revolucionarizuar pozitën industriale të grave – ajo i kishte gjetur ato shërbëtore dhe i kishte lënë pas të lira”. Kështu nisur nga ky këndvështrim, të jesh femër në të kaluarën konsiderohej si fatkeqësi sepse ato nuk kishin asnjë të drejtë si qenie njerëzore. Pra në periudhat e hershme femrat trajtoheshin njëllë sikur skllavërit dhe varësisht prej civilizimeve të mëparshme atyre u përshkruheshin tipare të ndryshme.

Në Europë tregtia me femra ishte diçka e zakonshme deri në vitin 1805, sipas kinezëve gruaja ishte gjëja më e pavlerë kurse sipas romakëve burri kishte të drejtë të braktisë apo edhe ta vrasë gruan. Kështu që të drejtat e tyre ato i kërkuar për herë të parë në shek. XIX përmes Lëvizjes Feministe. Kjo

lëvizje merrej me të drejtën e votimit, arsimimit dhe punësimit të tyre. Vendet e para në të cilat u kërkuar këto të drejta ishin: Në Francë dhe Holandë 1872, Angli 1890, kurse në SHBA 1910. Ndërsa për sa i përket të drejtave të votës për gratë ka qenë një lëvizje e madhe ajo që bëri të mundur këtë të drejtë.

Edhe pse e drejta e votës nuk ka qenë e njohur për të gjithë, pasi që një numër i sistemeve nuk kanë qenë demokratike. Shumë vende në Evropë, për shembull, kanë qenë monarki absolute, që do të thotë se një Mbretëreshë ose Mbret kanë sunduar popullin dhe vetëm një grup i kufizuar njerëzish (ata që ishin të pasur) gëzonin disa privilegje. Ndërkohë, vendet që më vonë kishin përvetësuar komunizmin kishin një formë të ndryshme të organizimit, i cili mbështetej në kontrollin e tërë aktivitetit ekonomik dhe shoqëror nga një sistem totalitar i dominuar nga një parti politike. Prandaj, në të dyja sistemet ose nuk ka pasur votime ose nëse ka pasur, ato ka qenë për një numër të vogël të privilegjuarish, ndërsa në asnjërin nuk ka pasur zgjedhje të lira. Megjithatë, edhe me demokratizimin e vendeve gratë nuk ishin njohur menjëherë si individë me të njëjtat të drejta të njeriut si burrat, dhe shumë vende kishin dështuar të njihnin të drejtën universale të votimit.

Gruaja zë një rol shumë të rëndësishëm në ditët e sotme në shoqëri, nëse i kthehemi kohës prapa, do të shohim se gratë janë përballur me shumë padrejtësi dhe


kanë luftuar fort për të fituar të drejtat e tyre. Gratë janë konsideruar “qenie të pa vlera” dhe të “paafte”, inferiore ndaj burrave dhe të pa afta për të arritur sukses. Me kalimin e kohës, gratë sot këto barrierat mendore dhe kompleksitetet i kanë zhdukur, dhe shoqëria e njeh rolin tejet të rëndësishëm që gratë e kanë në ditët e sotme. Gratë arrijnë të marrin arsimimin më të mirë dhe zotërojnë një sërë aftësish dhe kualifikimesh që kanë dhënë rezultate të kënaqshme në botën e punës. Po ashtu gratë kanë arritur të zënë poste prestigjioze, të drejtojnë si dhe të jenë pjesë e institucioneve shtetërore, ato tani nuk ndihen inferiore ndaj burrave dhe arrijnë të marrin vendime të rëndësishme dhe të jenë presidente të një shteti. Përkushtimi dhe puna e tyre ka bërë që shumë kompani sot

të preferojnë gratë ndaj burrave për zgjedhjen e çështjeve me rëndësi, numri i grave që punojnë është rritur dhe ky faktor ka bërë që ato të kenë fituar pavarësinë e tyre. Edhe roli i saj në familje ka ndryshuar, nëse dikur familjet ishin patriarkale, sot ka një balancim të autoriteteve dhe mendimi i gruas ka shumë peshë. Megjithatë nuk duhet anashkaluar fakti që shumë gra, sidomos në zonat rurale nuk kanë fituar ende rolin që u takon, ato janë ende të nënshtruara dhe ka raste kur këto gra janë viktimat të një mentaliteti mesjetar.

Sot gruaja ka ndikim të madh në politikën e një vendi po ashtu prania e grave në ekipet e menaxhimit përgjithësisht shoqërohet me një angazhim më të fortë shoqëror dhe me një stil lidërshipi më pjesëmarrës. Një analizë e ndikimit të grave

në ndërmarrjet bashkëpunuese, të cilat kanë karakteristika të veçanta në kuptim të organizimit dhe qëllimit, tregon se ndikimi i tyre çon në motivim më të madh dhe rezultate më të mira. Një përfitim i lidërshit femëror është një rritje në masat për të nxitur ekuilibrin e punës dhe familjes, i cili është i rëndësishëm për zhvillimin e vendit, si dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës së familjeve. Sipërmarrja e grave dhe prania e grave në ekipet e menaxhimit kanë një ndikim pozitiv në motivimet sociale dhe arritjet e organizatave. Me gratë në krye, kompanitë janë më të prirura për të futur politikat miqësore familjare. Konteksti i ri bashkëkohor sipërmarrës i sotëm është më i favorshëm për këtë lloj qasjeje sesa në botën tradicionale të biznesit. Në fakt, ndërmarrjet me bazë në komunitet





janë shfaqur si instrumente kyçe të fuqizimit të grave. Po ashtu si në biznes ashtu edhe në politikë, shumica thonë se gratë janë më të mira se burrat kur bëhet fjalë për të qenë të dhembshur dhe të ndjeshëm, dhe aksionet thelbësore thonë se gratë janë më të mira në kompromiset dhe qëndrimin për atë që besojnë.

Lidershipi i femrës është kthyer të jetë një fakt i epokës post moderne. I shfaqur si një fenomen i natyrshëm në të gjitha nivelet ai ka sjellë tipare që padysim kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve. Pothuaj të gjithë teoricienët e lidershit arrijnë në një pikë të përbashkët mendimi: lidershipi femëror prezanton tiparet e lidershit transformues, shpirtëror, pjesëmarrës e mbi të gjitha atij shërbëtor. Gjithashtu, të gjitha studimet njëzëri arrijnë në përfundimin se femrat në krahasim me meshkujt kanë një nivel më të lartë të inteligjencës emocionale dhe ky është një tjetër faktor që i bën ato të suksesshme në misionin e liderit. Sipas shumë studimeve shkencëtarët kanë ardhur në përfundim se femrat kanë përparësi në udhëheqje në krahasim me meshkujt

- Disa nga format dalluese të lidereve gra janë:**
- 1- Femrat kanë aftësinë dhe durimin të dëgjojnë dhe shfaqin tolerancë.

2- Femrat është e prirur të japë dashuri.

3- Askush më shumë se një femër mund të njohë artin.

4- Femrat janë sakrifikuese të mëdha.

5- Femrat janë të prirura për marrjen e iniciativës dhe dëshira e madhe për sukses dhe rezultate.

Në vitet e fundit për sa i përket pozitave udhëheqëse të femrave po ndryshon, çdo ditë e më shumë shohim drejtuese femra në administratë publike, në pozita udhëheqëse të larta ekzekutive shtetërore, në pozita ekzekutive në kompani të mëdha dhe kjo po reflekton dhe në organizatat e shoqërive civile

dhe për rrjedhojë edhe në sipërmarrje. Tani shohim që femrat janë të lira të demonstrojnë aftësitë e veta dhe të konkurrojnë në mënyre të barabartë me një burrë, duke fituar terren në pozicionet e drejtura deri dje nga meshkujt. Ndërkohë që burrat dhe gratë janë dy modele të ndryshme në udhëheqje, studimet e sociologeve dhe të psikologëve tregojnë se burrat janë më shumë të përqendruar te pushteti në kuptimin e prestigjit dhe statusit në hierarkinë shoqërore, ndërsa femrat bazohen në



ndikimin përmes bashkëpunimit me të tjerët duke kërkuar për mendime dhe këshilla. Ndërsa për sa i përket fushave në të cilat më së shumti dominojnë femrat është administrata, pra kjo është fusha në të cilën gjithnjë e më tepër po shtohet numri i femrave dhe përveç posteve të zakonshme në administrata po shtohen udhëheqëset femra.

Disa prej femrave të suksesshme në botë

Angela Dorothea Merkel, u lind më 17 korrik të vitit 1954 në Hamburg të Gjermanisë Perëndimore.

Angela Merkel është grua e paza-kontë, ajo është pjesë e politikës federale gjermane. Vetëm një vit pas angazhimit të saj të parë të mirëfilltë politik, gjatë kohës së kthesës, ajo ishte

bërë tashmë deputete e Bundestagut dhe ministre, më vonë u bë sekretare e përgjithshme e Unionit Demokristian të Gjermanisë (CDU-së) dhe si gruaja e parë në historinë e një partie popullore gjermane, madje u bë edhe kryetare federale e CDU-së. Kështu që Angela Merkel ose siç njihet ndryshe si “gruaja e hekurt” është një nga tre kancelarët e vetme që ka arritur të marrin mandatin e tretë. Gjatë udhëheqjes së saj, shumë gjëra ndryshuan në favor të shtetit të Gjermanisë si: rritja ekonomike, hapja

e shumë vendeve të punës, përparimi në reformat shtetërore e arsimore. Angela Merkel përveçse ishte kancelare e shtetit gjerman ajo gjithashtu luajti rol shumë të rëndësishëm në Politikën Europiane prandaj në vitin 2014 u zgjodh si personi i vitit nga revista prestigjioze New Your Times. Më 22 nëntor 2005, Merkel mori detyrën e kancelares së Gjermanisë pas bllokimit të zgjedhjeve që rezultoi në një koalicion të madh me SPD. Pra Angela Merkel bëhet kancelarja e parë femër e Gjermanisë dhe e para nga Gjermania Lindore që merr këtë post. Ajo bën pjesë në grupin e liderëve më me ndikim në botë dhe nga gazetarët e Britanisë të Madhe ajo është cilësuar si ish kryeministrja e tyre Margaret Thatcher, madje ata e cilësojnë Merkelin me të njëjtin pseudonim

si Thatcher duke e quajtur si “Gruaja e hekurt” gjermane. Merkel u angazhua edhe në politikën e shteteve të Ballkanit Perëndimor, sidomos për ndikimin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, që mes shteteve të arrihet një marrëveshje në të mirë të të dyja shteteve. Dhe ndikimi i saj për shtetin tonë është mjaft i madh për angazhimin dhe hyrjen e Kosovës në Bashkimin European (BE).

Hillary Diane Rodham Clinton, ka lindur më 26 tetor të vitit 1947, ajo u lind në Çikago, Illinois. Ajo fillimisht u angazhua në politikë, si studente në Wellesley College në vitin 1969 pastaj dhe u diplomua si juriste në vitin 1973 në Universitetin e Jalës. Pas diplomimit ajo u bë një avokate e shkëlqyer, duke këshilluar Fondin e Mbrojtjes të fëmijëve të Cambridge, përpara se të bashkohet me ekipin e juristëve që këshillonin për Komisionin Juridik përfaqësues gjatë fajësimit të Presidentit Richard Nixon. Ajo u martua me diplomatin e shkollës juridike Bill Clinton në vitin 1975. Në fillim të vitit 2007, Clinton njoftoi planet e saj për të kandiduar për presidencë. Gjatë vitit 2008, ajo pranoi emërimin kur u bë e qartë se Barak Obama mbajti shumicën e votës së delegatëve. Pas fitimit të zgjedhjeve kombëtare, Obama caktoi atë si sekretaren e SHBA-ve. Ajo u betua si pjesë e kabinetit të tij në Janar 2009 dhe shërbeu deri në vitin 2013. Në pranverën e vitit 2015, ajo njoftoi planet e saj për të kandiduar përsëri për presidencën e SHBA-ve. Në vitin 2016, ajo u bë gruaja e parë në historinë

e SHBA-së që u bë kandidati presiden-ciale i një partie të madhe politike. Pas një fushate polarizimi kundër kandidatit të GOP Donald Trump, Klinton u mund në zgjedhjet e përgjithshme. Si një zonjë e parë shteti, si një senatore dhe si një politikane me ndikim të madh në politikën amerikane Hillary dhe bashkëshorti i saj Bill Clinton, kanë bërë shumë të mira për vendin tonë prandaj edhe zëri dhe fuqia e saj kanë mjaft ndikim edhe në shtetin tonë, sepse përkrahja dhe ndihma e tyre për ne, ka qenë dhe është mjaft e madhe.

Madeline Korbelt Albright, ka lindur më 15 maj 1937 në Pragë, Çekosllovakia (tani Republika Çeke). Ishte femra e parë në postin e sekretarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

politikane dhe diplomate amerikane. Madeleine Albright është ish sekretarja e parë femër dhe njëherazi e nominuar nga presidenti i atëhershëm Bill Clinton dhe e konfirmuar si e tillë nga senati me 99 vota për asnjë kundër. Ajo ishte në postin e sekretares së Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga 23 Janari i vitit 1997 deri më 20 Janar të vitit 2010. Ajo bashkë me presidentin Bill Clinton kanë qenë ndër më kryesorët për çlirimin e Kosovës nga okupimi serb dhe kanë kontribuar në vazhdimësi për lirinë dhe pavarësinë e saj.

Margaret Hilda Thatcher, lindi më 13 tetor 1925 në Grantham.

Margaret Hilda Thatcher, Baronesha Thatcher ishte politikane Britanike dhe Kryeministrja e Mbretërisë së Bashkuar nga 1979 në 1990 si dhe drejtuesja e Partisë Konservatore. Ajo ishte kryeministrja britanike që shërbeu më gjatë e shekullit të 20-të dhe është e vetmja grua që ka mbajtur këtë detyrë. Një gazetar sovjetik e quajti atë “Zonja e Hekurt”, një nofkë që karakterizoi politikën e saj pa kompromis dhe stilin udhëheqës. Si Kryeministre, ajo zbatoi politika që njihen si Theçerizëm.

Fillimisht një kimiste para se të bëhej avokate, Thatcher u zgjodh anëtare e Parlamentit për zonën zgjedhore Finchley, në vitin 1959. Edward Heath e emëroi atë Sekretare të Shtetit për Arsimin dhe Shkencën në qeverinë e tij të vitit 1970. Në vitin 1975, Thatcher mundi Heath në zgjedhjet e udhëheqjes së Partisë Konservatore për t’u bërë kreu i Opozitës dhe u bë gruaja e parë të udhëhiqte një parti të madhe politike në Mbretërinë e Bashkuar. Filozofia e saj politike dhe politikat e saj ekonomike theksuan çlirimin nga rregullat të sektorëve të ekonomisë (veçanërisht të sektorit financiar), bërjen e tregjeve të punës më fleksibël, privatizimin i kompanive shtetërore dhe uljen e fuqisë dhe ndikimit të sindikatave. Popullariteti i Theçerit gjatë viteve të saj të para në detyrë filloi të bjerë për shkak recesionit dhe papunësisë së lartë, deri në 1982 kur Lufta e Falklandeve solli një rigjallërim të mbështetjes, duke rezultuar në rizgjedhjen e saj në vitin 1983.

Thatcher u rizgjodh për një mandat të tretë në vitin 1987. Gjatë kësaj periudhe mbështetja e saj për një Taksë të Komunitetit (gjerësisht referuar si “taksë votimi”) ishte gjerësisht jopopullore dhe pikëpamjet e saj mbi Komunitetin European nuk përputheshin me atë të disa pjesëtarëve të kabinetit të saj. Ajo dha dorëheqjen si kryeministre dhe udhëheqja e partisë në nëntor 1990, pasi Michael Heseltine nisi një sfidë për udhëheqjen e saj. Pas largimit nga Dhoma e Ulët (Commons) në vitin 1992, asaj iu dha titulli Baroneshë e Kesteven në qarkun e Lincolnshire, që i jepte asaj të drejtën të merrte pjesë në Dhomën e Lordëve. Ajo u tërhoq nga paraqitjet publike për shkak të shëndetit të saj.

“Nëse kritikët e mi do të më shihnin duke ecur përmbi ujërat e deteve ata do të thoshin se kjo ndodh për shkak se unë nuk di të notoj”, -Margaret Thatcher. Kjo është femra!

Kështjellat në Shqipëri

Një popull me kaq lashtësi s'mund ta harrojë kurrë historinë e tij

Ndërtime të mëdha mbrojtëse, të përbëra nga mure rrethuese të forta me kulla të larta dhe nga ndërtesa e mjedise të brendshme të nevojshme për jetesë e për t'u mbrojtur në rast lufte. Kështjellat e para në trojet shqiptare janë ngritur qysh në neolitin e vonë. Njihen disa kështjella ilire si Rozafa në Shkodër, Kështjella e Beratit, Lis, Bylis, etj.

Më pas u ngritën kështjella edhe në zonat e ulëta dhe në vende strategjike si Kështjella e Durrësit, Kështjella e Gjirokastrës, Kështjella e Elbasanit e më vonë edhe Kështjella e Krujës. Këto kështjella janë një pasuri e madhe për kombin shqiptar. Ato tregojnë për lashtësinë e tij në Ballkan, për artin e të ndërtuarit dhe për qëndresën e tij në shekuj kundër armiqve që i janë kanosur. Kështjellat kanë vlera të mëdha kulturore dhe turistike.



Kështjella e Beratit

Kështjellë e lashtë në Berat e ngritur në kodrën shkëmbore të qytetit, në lartësi 187 metra, në anë të lumit Osum. I përkiste fisit ilir të Dasaretëve. Si pikë e rëndësishme u shndërrua në qytet kështjelle me mure të lartë që përfshijnë një sipërfaqe prej rreth 10 hektarësh. Përmendet me emrin e lashtë Antipatrea, kur u sulmua nga Skardilajdi gjatë luftimeve maqedono-romake. Perandori bizantin Teodori II e përforcoi dhe i vuri emrin Pulheriopolis. Nga romakët u quajt edhe me emrin Albanorum oppidum (Fortesa e Arbërve). Në shek. XIV ishte qendër e principatës së Muzakajve. U pushtua nga osmanët më 1417. U morr në dorë nga Ali Pashë Tepelena më 1809, që ia përforcoi muret. Për madhësinë dhe objektet që ka, tërheq shumë vizitorë.

Kështjella e Shkodrës

Kështjella e Shkodrës nga vendasit thirret me emrin Rozafa. Ngrihet mbi një kodër shkëmbore në perëndim të qytetit, midis lumenjve Drin dhe Bunë. Muret e saj rrethojnë 9 hektarë tokë. Hyrjen kryesore e ka nga verilindja. Njihet si qendër e fortifikuar qysh në periudhën e mbretit ilir Gent. Me emrin Rozafa del që nga shek. VI. Sipas legjendës, në muret e saj u muros e gjallë Rozafa, nusja e vëllait më të vogël, e njërit nga tre vëllezërit që e ngritën këtë kështjellë.



Bazë e legjendës është mbajtja e fjalës së dhënë dhe flitimi për hir të së ardhmes. Kështjella ka qenë simbol i qëndresës. Në periudha të

ndryshme historike ka qenë edhe nën bizantinët, sllavët e më pas nën pushtuesit osmanë. Në shek XIV u zotërua nga Balshajt, ndërsa familja e Bushatasve aty pat ngritur pallatin e saj. Në përgjithësi Rozafa ruhet mirë dhe tërheq turistë e vizitorë të ndryshëm.

Kalaja e Durrësit

Kalaja e Durrësit muret e së cilës u ringritën në periudhën e perandorit bizantin Anastasi I me origjinë nga Durrësi, i cili e shndërroi atë në një nga qytetet më të fortifikuara në Adriatik. Riparime në mure janë kryer edhe pas tërmetit shkatërrues të vitit 1273. Aktualisht muret mesjetare me lartësi afro 15 metra si dhe tre hyrje e disa kulla fortifikuese ruhen në afro një të tretën e gjatësisë fillestare të kështjellës së qytetit.



Kalaja e Tiranës

Kalaja e Tiranës ishte një stacion rrugor i vijës Egnatia i tipit Mansio-Mutatio. Ajo përbënte qendrën e një vendbanimi, të emërtuar me një variacion emrash që në shekujt e parë të erës sonë. Tirkan (shek. IV e. s.), Tergiana (1297) kur në të ishte vendosur kancelaria e sundimtarit të saj Karli I Anzhu, dhe në formën e sotme Tyranna (1505) sipas Barletit. Ky toponim akoma nuk është saktësuar plotësisht. Por kalaja, dëshmia më e lashtë e këtij qyteti, ndodhet pikërisht në vendin ku derdeshin e kryqëzoheshin rrugët e vjetra e të reja që e lidhnin kryeqytetin dhe pastaj krejt Shqipërinë – veriu me jugun,



lindjen me perëndimin. Në ambientet e Kalasë së Tiranës ka disa shtëpi tradicionale të cilat kanë krijuar stilin e ndërtesës qytetare Tiranase. Në ndërtesat brenda Kalasë së Tiranës kanë banuar pjesëtarë të familjeve sunduese të qytetit dhe për këtë arsye ato konsiderohen edhe si godina të administratës së parë lokale.

Kalaja e Ali Pashës në Tepelenë

Kalaja e Tepelenës është një monument me vlera të jashtëzakonshme historike e kulturore. Në Mesjetë shquhej për pozitën e saj strategjike, duke pasur nën kontroll rrugët, nga Gjirokastra përgjatë luginës së Drinos dhe tjetra nga Përmeti gjatë luginës së Vjosës. Kalaja e Ali Pashë Tepelenës pozicionuar në veri të qytetit, u rindërtua prej Pashait më 1819, me një sipërfaqe 4-5 ha me tre hyrje dhe 3 kulla. Kjo kala ka pasur brenda saraje, garnizone dhe ambiente të një jete aristokratike nisur kjo nga struktura solide dhe organizimi perfekt.



Kalaja e Bashtovës

Kalaja e Bashtovës (Castle Bashtova) ngrihet pranë fshatit të Vile-Bashtovës në një distancë prej 3-4 km, në veri të grykëderdhjes së lumit të Shkumbinit. Kështjella është ndërtuar në shekullin XV dhe u ka shërbyer venecianëve, për shkëmbime tregtare. E veçanta e kësaj Kalaje ose Kështjelle është se kjo kështjellë është e vetmja kështjellë në Ballkan e ndërtuar në fushë. Rrethinat e saj kanë mbetur të plota dhe sot ruhen si një monument kulture nga shteti shqiptar.



Kalaja e Drishtit, Shkodër

Kalaja e Drishtit gjendet në një distancë prej 6 km nga Ura e Mesit mbi lumin Kir. Fshati i sotëm ndodhet poshtë vendgërmimit të Drivastumit të lashtë. Ai u ngrit në periudhën romake si një vendbanim në rrugën Shkodër-Kosovë dhe në antikitetin e vonë ishte njëra prej fortesave zinxhir, të cilat mbronin Shkodrën. Në shek. IX, Drishti u kthye në një fortifikim të rëndësishëm të Mbretërisë së Zetës dhe varej nga Dioqeza e Tivarit. Kalaja e Drishtit u ngrit në shek. XIII si një fortesë bizantine. Gjatë shekujve XIV-XV kalaja së bashku me qytetin kaloi nga njëri sundues tek tjetri, derisa më 1478 bie në duart e osmanëve, të cilët u përpoqën ta meremetonin.



Kalaja e Krujës

Kalaja e Krujës është një nga kalatë me të njohura në Shqipëri. Kjo kala me trajtë eliptike dhe me perimetër 804 m, zë një sipërfaqe prej 2.5 ha tokë dhe është ngritur në një kodër shkëmbore. Gërmimet arkeologjike të vitit 1978 dëshmojnë se kodra ka qenë e banuar që në shek. e III p. e. r. ndërsa kalaja është ngritur në shek. V-VI e. r. Pranë saj është zbuluar një varrezë e madhe e kulturës arbërore. Përmendet me emrin e sotëm në shek. e IX bashkë me qytetin e Krujës si qendër peshkopale. Në shek. XIII-XIV ishte qendra e shtetit të Arbrit. Gjatë periudhës së Skënderbeut u bë krye-fortesa e qëndresës së shqiptarëve kundër pushtimit osman. Edhe në ditët e sotme njihet si një ndër vendet më të njohura dhe më të vizituar nga turistët.



Kalaja e Porto Palermos

Kalaja e vogël është e vendosur në një pozicion mjaft të bukur në një gadishull në gjirin e vogël tektonik të Porto Palermos (në antikitet e njohur si gjiri i Panormes). Kalaja ndodhet jo larg fshatit të Qeparosë dhe ka formë trekëndore. Përmasat e saj janë 150 m x 400 m. Lartësia e mureve arrin në 20 m. Kalaja e Porto Palermos ndodhet në gjirin me të njëjtin emër në bregun e detit Jon në Shqipërinë e jugut. Kalaja ndodhet mbi një ishull rreth 30 m larg bregut ku rripi i ngushtë ujon midis bregut dhe ishullit është mbushur me dhe e me gurë për të realizuar një lidhje tokësore me të. Kalaja ka formë planimetrike trekëndore me tre bastione të fuqishme nëpër qoshet. Hyrja ndodhet në mesin e murit jugor. Nga ana e detit, midis dy bastioneve një sipërfaqe në formë trapezi është rrethuar me mure të pajisura me frëngji. Pjesa tjetër e kështjellës përbëhet nga një numër i madh ambientesh të mbuluara me qemerë të cilat përfundojnë në pjesën e sipërme me një tarracë të përbashkët. Ambientet shërbenin për strehimin e garnizonit, ndërsa njeri prej tyre shërbente si burg.



Kalaja është shumë më e vjetër se Ali Pasha, ai e ka restauruar, e ka pasur në kontroll këtë pikë dhe ka qenë aty vetëm si vizitor, nuk ka jetuar kurrë aty. Kishën (Shën Nikolla) nuk e ka bërë ai, ka qene atje, dhe gjelbërimi nuk është gjithë-vjeçar në dimër thahet.

Kalaja e Borshit

Kalaja e Borshit (ose Kalaja e Sopotit siç njihet ne histori) ndodhet mbi një kodër të fshatit Borsh që është 500 m mbi nivelin e detit dhe daton rreth shekullit IV-III p. k.. Kodra e Sopotit, mbi të cilën ngrihet kalaja, ndodhet në Veri të fshatit Borsh dhe në perëndim të Fterres. Sipërfaqja e saj është shkëmbore. Nga ana Perëndimore mali formon disa tarraca natyrale, ku duken një sërë tepricash të godinave mesjetare. Mbeturina muresh të kohës antike duken në anën jugperëndimore në një gjatësi prej rreth 10 metra dhe një lartësi prej 1,33 m. Në sipërfaqen e qytezës, janë gjetur fragmente enësh me vernik të zi, të shekullit të IV para erës sonë (periudha pare).



Kalaja e Kaninës

Kalaja e Kaninës është një monument i trashëgimisë kulturore në Kaninë, Rrethi i Vlorës, në qarkun e Vlorës. Ky monument është i llojit “Arkeologji”, i miratuar me numër “Nr.95 Dt. 1.10.1948”. Kalaja e Kaninës ndodhet 6 km larg nga qyteti i Vlorës, në një kodër me lartësi 380m mbi nivelin e detit. Muri rrethues është i gjatë 1 km dhe përfshin një sipërfaqe prej 3.5 hektarësh. Mendohet të jetë ngritur aty nga shekulli i IV p. e. r. Në të gjithë sistemin fortifikues dallojmë disa faza ndërtimi që shtrihen në dy periudha, në periudhën antike si dhe në atë të periudhës mesjetare, përkatësisht bizantine, veneciane dhe



turke. Kalaja u rindërtua nga Justiniani në shekullin VI, i cili në Epir ndërtoi ose rindërtoi 94 fortifikime. Ajo përmendet nga Prokopi i Çezaresë në listën e tij me emrin Kionin. Në shekujt XII-XIII u kthye në një qendër ushtarake të dorës së parë, duke i shërbyer Mbretërisë Mesjetare e të Shqipërisë anzuine. Gjithashtu u meremetua nga sulltan Sulejmani më 1530 dhe së fundmi nga feudalët shqiptarë të Vlorës ne shekujt XVII-XIX.

Kalaja e Rodonit

Kalaja e Rodonit ndodhet në kepin e Rodonit. Princi Karl Topia dëshironte ta kthente këtë vend në një kantier detar, ndërsa Skënderbeu, duke synuar që të kishte një dalje të afërt në det, ngriti këtu një kështjellë. Kjo kala filloi të ngrihej mbas rrethimit të parë të Krujës në vitin 1450. Përfundimi i saj mendohet të jetë rreth vitit 1452. Muri i kështjellës së Rodonit arrinte në një gjatësi prej 400 metrash dhe në kulmet e saj kishte kulla të rrumbullakëta. Në vitin 1500 kalaja u pushtua nga Venediku. Si rezultat i veprimtarive erozive të ujërave të detit, një pjesë e mureve janë zhytur nën ujërat e detit Adriatik. Sot vizitorët mund të shikojnë muret e jashtme të anës së djathtë, të cilat përfundojnë me një kullë të rrumbullakët. Pranë kalasë ndodhen edhe rrënojat e Kishës së Shën Pjetrit, të cilat konsiderohen nga banorët si vend i shenjtë.



Kalaja e Lezhës

Kalaja ngrihet në majë të një kodre me lartësi 186 metra, në lindje të qytetit. Kalaja ka origjinë ilire. Në vitin 1440 ajo iu nënshtrua një rindërtimi nga venedikasit, ndërsa në vitin 1522 pas pushtimit osman u rindërtua edhe nga ana e tyre. Këtu mund të shikohen gjurmë të arkitekturave ilire, romake, bizantine dhe osmane. Objektet më interesante për t’u vizituar janë rrënojat e ndërtesave osmane brenda kalasë, xhamia, kulla në murin juglindor me një hark romak dhe kulla ilire në murin jugor. Kalaja e Lezhës është monument kulture. Prej saj shihet një pamje mjaft e bukur e fushës së Lezhës dhe e detit Adriatik. Kalaja e ndërtuar në kodër ka një pozicion strategjik që kontrollon luginën e Drinit deri në Gjirin e Shën Gjoni në detin Adriatik.



Kalaja e Prezës

Kalaja e Prezës është ndërtuar mbi një shkëmb i cili zgjatet duke u ulur në drejtim të veri-jugut. Ana lindore e kalasë është e mbrojtur nga vetë terreni, kurse ana perëndimore përbën një territor të sheshtë, prandaj dhe fortifikimi është përqendruar pikërisht në këtë pjesë. Sipas autorit Papajani kjo kala është braktisur në kohën e Gjon Kastriotit, dhe më vonë nuk u rindërtua më. Pas pushtimit të Krujës nga osmanët, aty u bënë disa rindërtime, si dhe u ndërtuan një objekt kult.



Kalaja e Elbasanit

Kalaja e Elbasanit është një kala 2000-vjecare. Ajo ndodhet në qendër të qytetit të Elbasanit dhe dikur ka qenë kështjellë ushtarake. Përmes saj kalonte rruga Egnatia, që në atë kohë ishte një rrugë e rëndësishme. Si një objekt historik shumë i rëndësishëm, kalaja është shpallur monument kulture. Brenda saj ndodhen edhe shumë objekte të tjera historike dhe kulturore, si: kulla e sahatit, hamami i vjetër, Xhamia Mbret, Kisha Fjetja e Shën Mërisë etj.

Kalaja e Elbasanit së bashku me muret rrethuese, tregon për rëndësinë ushtarake të qytetit të Elbasanit në periudhën e hershme Osmane. Muri jugor, pak a shume i plotë, dëshmon për përmasat dhe fuqinë e fortifikimeve si dhe




një pjesë e materialeve nga periudha romake e bizantine që janë përdorur gjatë rindërtimit nga Mehmeti i II, mund të shihen qartë në themelet e kullës jug perëndimore. Kjo kala ka pasur 26 kulla në largësi të barabartë nga njëra tjetra, gjatë gjithë murit me lartësi 9 m. Në këtë fortesë përfshihet një pjesë e “Via Egnatia”-s që kalon përmes saj.

Kalaja e Gjirokastrës

Kalaja e Gjirokastrës si histori e lidhur me qytetin e Gjirokastrës, përmendet për herë të parë si qytet dhe kështjellë në vitin 1336. Në këto vite, ajo ishte qendra e feudalëve shqiptarë Zenevisë. Më vonë, gjatë sundimit të Gjin Bue Shpatës, ajo u përfshi në Despotatin e Epirit. E megjithatë historianë të ndryshëm mendojnë se ekzistenca e kalasë së gurtë është më e hershme. Sipas tyre, kalaja ka pas dy faza ndërtimi, të cilat lidhen me periudhën para dhe pas Pashallëkut të Janinës dhe fortesave të Ali Pashë Tepelenës. Nga Kalaja mesjetare, ajo e para pushtimit osman-shqiptar të Ali Pashës, ruhen vetëm pak gjurmë pasi muret janë veshur deri në lartësi nga ndërtimet e reja. Ndërsa, kullat pjesërisht janë rrënuar dhe ripërshtatur.





Kryeministri Kurti theksoi se ngritja e ushtrisë është detyrë e përbashkët dhe se Qeveria e Republikës së Kosovës e merr me shumë përkushtim modernizimin e ushtrisë si me pajisje dhe me armatim, ashtu edhe kushtet e shërbimit, si dhe me ofrimin e mundësive ku ushtarët mund t'i tregojnë shkathtësitë e tyre.



Kryeministri Kurti dhe ministri Mehaj vizituan Regjimentin e parë të Forcave Tokësore të FSK-së

“Profesionalizëm dhe përkushtim në shërbim të paqes e sigurisë”

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, zëvendësministri Shemsi Syla dhe zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, në përvjetorin e 38-të të rënies së heronjve, Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha, vizituan Regjimentin e parë të Forcave Tokësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në Kazermën “New Born”, në Gjilan.

Në fjalimin para pjesëtarëve të Regjimentit, kryeministri Kurti u shpreh i nderuar dhe krenar për vizitën dhe shtoi se nuk ka mënyrë më të mirë për të filluar vitin e ri.

Kryeministri Kurti theksoi se ngritja e ushtrisë është detyrë e përbashkët dhe se Qeveria e Republikës së Kosovës e merr me shumë përkushtim modernizimin e ushtrisë si me pajisje dhe me armatim, ashtu edhe kushtet e shërbimit, si dhe me ofrimin e mundësive ku ushtarët mund t'i tregojnë shkathtësitë e tyre.

Më tej, ai tha se këmbësoria, si degë më e vjetër e ushtrisë, dëshmon që teknologjia dhe pajisjet ushtarake, sado të sofistikuar dhe precize, nuk mund ta zëvendësojnë vrullin dhe fuqinë e luftarakut të zot.

“Në vitin që lamë pas, FSK-ja tregoi profesionalizëm të lartë, përkushtim në shërbim të paqes e sigurisë, jo vetëm brenda kufijve të saj, por edhe jashtë, si dhe, jo vetëm për qytetarët e saj, por edhe të gjithë ata që kanë nevojë”, tha



kryeministri Kurti.

Gjatë fjalimit të tij, ai theksoi si një ndër sukseset më të larta të vitit 2021, pjesëmarrjen në “Defender Europe ‘21”, ku u tregua gatishmëria, profesionalizmi dhe ndërveprimi me


ushtarakët e NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

“Pjesëmarrja në ushtrimin ndërkombëtar mjaft i suksesshëm i kompanisë tuaj, është testament i arritjeve, të cilët na bëni çdo ditë krenarë të gjithë neve”,

tha kryeministri Kurti. Ai shprehu bindjen se sfida e radhës, “Defender Europe ‘23”, do t'i gjejë edhe më mirë, edhe më të përgatitur. Në të njëjtën ditë, me rastin e 38-vjetorit të rënies së dëshmorëve Rexhep Mala dhe Nuhi

Berisha, ministri Mehaj, në shoqërim të zëvendësministrit Syla dhe stafit të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, vizituan familjet e tyre në Gjilan. Ata gjithashtu bënë homazhe në varrezat e dëshmorëve të komunës së Gjilanit.





“Nuk ka kënaqësi më të madhe se mundësia për të kontribuar për kombin, për vendin, për qytetarët. Kam pasur mundësinë të kontribuoj për diçka më të madhe se vetja. Nëse ka një fjalë që e kemi përsëritur në dekadat e fundit, ajo është se vendi dhe qytetarët e tij duan të jenë pjesë e Bashkimit European dhe NATO-s”, -tha ministrja Shekerinska, duke shtuar se në katër vjet e gjysmë kemi përfunduar detyrat tona të shtëpisë dhe anëtarësimi në NATO ka treguar se përkushtimi dhe puna e palodhur sjellin rezultate.



Mirënjohje nga Asociacioni i Atasheve të Mbrojtjes të akredituar në Maqedoninë e Veriut

Ministrja e Mbrojtjes Shekerinska: Vendi dhe qytetarët e tij duan të jenë pjesë e Bashkimit Evropian dhe NATO-s

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska, merr mirënjohjen nga Asociacioni i Atasheve të Mbrojtjes të akredituar në Maqedoninë e Veriut, siç tha presidenti i saj, atasheu i mbrojtjes i SHBA-së, kolonel Piter Rauell, për “udhëheqjen e saj në procesin e anëtarësimit të vendit tonë në Aleancë dhe vizionin e saj për zhvillim të Mbrojtjes dhe Armatës në përputhje me standardet e Aleancës”. Mirënjohja iu dha ministres Shekerinska pas konferencës së rregullt vjetore me përfaqësuesit e ushtrive aleate.

Ministrja Shekerinska falënderoi për këtë gjest dhe tha se katër vitet e gjysmë ishin të vështira, por edhe se e gjithë ajo punë dhe rezultat sepse rezultati është i dukshëm.

“Nuk ka kënaqësi më të madhe se mundësia për të kontribuar për kombin, për vendin, për qytetarët. Kam pasur mundësinë të kontribuoj për diçka më të madhe se vetja. Nëse ka një fjalë që e kemi përsëritur në dekadat e fundit, ajo është se vendi dhe qytetarët e tij duan të jenë pjesë e Bashkimit European dhe NATO-s”, -tha ministrja Shekerinska, duke shtuar se në katër vjet e gjysmë kemi përfunduar detyrat tona të shtëpisë dhe anëtarësimi në NATO ka treguar se përkushtimi dhe puna e palodhur sjellin rezultate.

Ajo falënderoi atashetë e mbrojtjes për mbështetjen e vazhdueshme, për të gjitha këshillat, për forcën që na dhanë në momente të vështira për të ecur përpara.

“Partnerët dhe aleatët na dhanë forcë kur humbëm. Ju besuat tek ne kur ne vetë kishim dyshime. Ju na keni dhënë këshilla të sinqerta dhe miqësore, dhe ato këshilla ndonjëherë janë më të vështirat për t’u dëgjuar dhe kuptuar. Por ato këshilla janë më të mirat që mund të jepen dhe unë ju falënderoj për këtë”, -tha ministrja Shekerinska për atashetë e mbrojtjes.

Ceremonia e ndarjes së mirënjohjes u parapri nga një konferencë e rregullt vjetore me atashetë e mbrojtjes të akredituar në Maqedoninë e Veriut, në të cilën ministrja Shekerinska iu referua arritjeve në mbrojtje në vitin 2021.

Vitin e kaluar ministrja Shekerinska e vlerësoi si vit të vështirë por jashtëzakonisht të suksesshëm për mbrojtjen.

“Në përvjetorin e parë të anëtarësimit në NATO, kemi përfunduar integrimin tonë ushtarak në Aleancë dhe aleatët tanë na kanë



përgëzuar që ky është integrimi më i shpejtë ushtarak i një shteti anëtar deri më sot. Vitin e mbyllëm me

98.6% realizim të buxhetit – mjeteve, shumica e të cilave ishin të destinuara për modernizimin e Armatës. Kemi

investuar në kapacitetet e Krivollakut, i cili po bëhet poligoni më i mirë për aleatët në Europë, kemi konfirmuar

se Maqedonia e Veriut është anëtare e NATO-s që kontribuon në sigurinë rajonale dhe aftësinë e Aleancës për të përballuar çdo sfidë. Mbi të gjitha ne kemi investuar në aleancë, unitet dhe vlera të përbashkëta. E gjithë kjo nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e vazhdueshme të atasheve të mbrojtjes të akredituar në Maqedoninë e Veriut. Suksesi ynë është konfirmimi më i mirë i parimit të NATO-s – së bashku jemi më të fortë!”, -tha ministrja Shekerinska.

“Duke pasur parasysh të gjitha sfidat e sigurisë, viti 2021 na ka dhënë shumë mundësi për të qenë më të mirë në atë që bëjmë si udhëheqës dhe për t’i bërë institucionet tona më të forta dhe më elastike ndaj kërcënimeve të reja”, -u tha ministrja atasheve të mbrojtjes.

INVESTIMET NË KRIVOLAK KAPACITET I VLEFSHËM VENDOR DHE I NATO-S

Stërvitja aleate SWIFT RESPONSE - 22 do të përfshijë dhe zbarkim nga ajri me mbi 1000 parashutistë

Investimet në infrastrukturën dhe kushtet e Krivollakut e legjitimojnë atë si një nga terrenet ushtarake më të mëdha dhe më të mira, jo vetëm në rajon, por edhe në Europë. “Sot jemi edhe një herë të bindur se Krivollaku ka marrë një fytyrë të re dhe bëhet një terren modern stërvitor për ushtritë tona dhe aleate, kapacitet i vlefshëm i brendshëm dhe i NATO-s dhe kontribut i yni si anëtarë të NATO-s në gatishmërinë e forcave të Aleancës”, -tha ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska, së bashku me përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe përfaqësues të ambasadës amerikane, në inspektimin e rikonstruimit dhe ndërtimeve që po kryhen në disa lokacione në poligonin e Krivollakut.

“Investimi në Krivollak për të cilin jemi angazhuar në dy vitet e fundit është një investim i vlefshëm sepse kemi fituar besimin e aleatëve dhe interesimi i tyre për poligonin po rritet. Krivollaku këtë vit është vendi ku do të zhvillohen 7 stërvitje ndërkombëtare, me pjesëmarrjen e 5200 pjesëtarëve të disa ushtrive aleate. Më e madhja prej tyre, por edhe stërvitja më e madhe ndërkombëtare në



përgjithësi në poligonin tonë stërvitor, do të jetë stërvitja SWIFT RESPONSE - 22 e cila do të sjellë 4000 pjesëmarrës nga ushtritë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar, Italisë, Francës, Malit të Zi, Shqipërisë dhe natyrisht nga Maqedonia e Veriut”, -tha ministrja Shekerinska.

Karakteristikë e këtij ushtrimi është elementi i tij ajror, duke përdorur një numër të madh avionësh transportues dhe sulmues dhe helikopterë dhe zbarkim nga ajri (me parashutë) të rreth 1000 parashutistëve. Ky lloj ushtrimi do të kryhet për herë të parë në vendin tonë dhe do të jetë një test i kapaciteteve infrastrukturore të vendit, por edhe një shans për

kompanitë vendase të logjistikës.

“Rrugët e reja 33 km në Krivolak, tualetet e reja të vendosura në kampet “Shigjeta” dhe “Dimri” të ndërtuara si objekte efikase energjetike me impiante trajtimi, por edhe poligonet e reja të qitjes, pistën për dronët, magazinat për objektivat, të cilat mundësuan që kjo stërvitje, më e madhja për nga numri i pjesëmarrësve dhe shfrytëzimi i kapaciteteve të Krivollakut, të mbahet në vendin tonë”, -tha Shekerinska. Atasheu i Mbrojtjes i SHBA-së, Piter Rauell tha se Krivollaku po zhvillohet në zonën më të mirë të trajnimit të NATO-s në Europë. “Bashkëpunimi ynë në zhvillimin e Krivollakut është një nga demonstrimet më të mira të bashkëpunimit të thellë dhe të frytshëm të mbrojtjes mes dy vendeve. Jam krenar që së bashku kemi zhvilluar projekte që kanë rritur potencialin e poligonit. Këtu u mbajtën ushtrime të shumta që treguan kapacitetin e Krivollakut. “Këtë pranverë do të shohim edhe një herë kapacitetin unik të poligonit kur Maqedonia e Veriut do të presë 4000 trupa nga shtatë vende të NATO-s në stërvitjen Swift Response 22”, -tha koloneli Rauell.

Shkolla "Skënderbej", fidanishtja e përgatitjes së sportistëve të Partizanit

Skënderbegasit e të gjitha periudhave 1945-1992 janë përgatitur në mënyrë të shkëlqyer në bankat e shkollës "Skënderbej", në përvetësimin e programeve mësimore edukative dhe të përgatitjes fiziko-ushtarake, duke qenë të aftë e të gatshëm për të vazhduar me sukses shkollat e larta ushtarake e civile, brenda dhe jashtë vendit. Shkëlqyen në disiplina të ndryshme sportive djemtë e kësaj shkolle elitë të kohës

Isa Hamza Tare, lindur në Nivicë-Tepelenë dhe banues në Tiranë, gjatë karrierës së tij akademike dhe sportive prej pesë dekadash, është nderuar me dhjetëra Urdhra e Medalje. Pas diplomimit në Akademine të Sporteve Tiranë, si dhe mbarimit me rezultate të shkëlqyera të Kursit pasuniversitar dhe të Kurseve të tjera kualifikimi në Shqipëri dhe në Kinë, shërbeu për 10 vjet (1970-1980) si pedagog dhe Shef i Departamentit të Fiskulturës në Akademinë Ushtarake. Për gjashtë vjet (1980-1986) ishte pedagog në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe më pas për 10 vjet (1986-1995) kreu me devotshmëri, përkushtim e kompetencë funksionet e Inspektorit të Sporteve bazë: not, shah, atletikë, gjimnastikë dhe Drejtor Ekzekutiv i Klubit Shumësportësh "Partizani". Gjatë kësaj periudhe, si Drejtor Ekzekutiv i Klubit Shumësportësh "Partizani", ka punuar për ngritjen e të gjithë strukturave të këtij klubi. Prestigji i Mjeshtrit të Merituar Isa Tare do të rritej ndjeshëm, pasi duke e drejtuar me kompetencë e profesionalizëm arriti ta shpallë atë Klubin më të mirë të Republikës për disa sporte. Gjatë kësaj kohe janë fituar disa medalje ndërkombëtare në sportet si mundje, atletikë, gjimnastikë, peshëngritje, boks dhe karate. Për sa i përket karrierës sportive, z. Isa Tare është shpallur Rekordmen i Ballkanit për "Flakjen e Diskut për Mosha" (1996). Po ashtu është fitues i tre Medaljeve të Arta në Spartakiadat Kombëtare. Ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e rëndësishme kombëtare, ku përfshihen 300 gara kombëtare, (në 180 gara ka fituar vendin e parë), si dhe në 83 takime ndërkombëtare, ku në 50 gara ka fituar vendin e parë. Në vitin 1972 ka plotësuar normën e pjesëmarrjes në Kampionatin European të Helsinkit. Po ashtu në takimin e Pekinit më 1965 është fitues i vendit të parë midis tre fituesve të Lojërave të Ganefos, duke thyer dhe rekordin kombëtar në flakjen e diskut. Është shpallur Kampion dhe Rekordmen i Flakjes së Diskut për 27 vite me radhë, duke fituar 27 medalje të kampionit kombëtar (15 në hedhje disku dhe 12 në shtytje të gjyles). Trofetë janë shumë. Për disa dekada fitues i vendeve të para në të gjitha aktiv-



itetet kombëtare (kupa, kampionate, spartakiada) ballkaniada, lojëra mesdhetare, kampionate europiane dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare. Karriera e shkëlqyer sportive ka bërë që Isa Tare të mbajë "Gjerdanin e Artë" të disa dekoratave. Ai nderohet me titujt "Mjeshtër Sporti" (1964) dhe "Mjeshtër i Merituar Sporti" (1981). Z. Isa Tare është dekoruar: me Urdhrin e Punës të Klasit të Dytë, me Dekret Nr.7334 dt.13.11.1989; me Urdhrin e Artë, "Naim Frashëri", me Dekret nr.1516 dt. 04.07.1996 të Presidentit të Republikës; me Medaljen e Artë "Për Merita të Veçanta në Fushën e Sportit", nga ish Ministri i Kulturës dhe Sporteve Teodor Laço, më 08.06.1996 si dhe "Nderi i Sportit Shqiptar". Z. Isa Tare ka qenë për tetë vjet anëtar i Kryesisë dhe zv. President i Federatës Shqiptare të Atletikës. Si drejtues, ka shoqëruar dhe drejtuar dhjetëra herë ekipet sportive shqiptare (atletikë, gjimnastikë, mundje, boks etj.), në takime ndërkombëtare. Këshilli Bashkiak i Tiranës, me Vendimin Nr. 59. dt. 21.04.2000, i ka dhënë Medaljen "Mirënjohja e Qytetit të Tiranës". Federata Shqiptare e Atletikës, me Shkresën Nr.129 Prot. dt. 9 shkurt 2006 konfirmon se "të gjitha rezultatet dhe arritjet e Mjeshtrit të Merituar të Sportit z. Isa Tare janë të evidentuara në dokumentet e FSHA". Gjatë karrierës së tij sportive është shpallur Kampion dhe Rekordmen në Flakjen e Diskut dhe gjyles për 27 vjet me radhë, duke fituar 27 medalje të kampionit kombëtar, dhe tre medalje të arta në

spartakiadat kombëtare.

Është dekoruar nga Presidenti i Republikës Bujar Nishani me Titullin "Mjeshtër i madh".

Kastriot Mushi, basketbollisti i shquar i Partizanit në vitet '70-'80, njëkohësisht një nga basketbollistët më të shquar shqiptarë, jo vetëm



të Partizanit por dhe kombëtares shqiptare. Kampion me fanellën e kuqe në 13 sezone: 1972-'73, 1973-'74, 1974-'75, 1975-'76, 1976-'77, 1977-'78, 1978-'79, 1979-'80, 1980-'81, 1981-'82, 1982-'83, 1983-'84, 1984-'85, si dhe 7 kupa të republikës më 1975, 1976, 1978, 1980, 1982, 1983, 1984, ku në 14 vite fitoi aq shumë me Partizanin krahas basketbollistëve të tjerë. Përfaqësues vigan i disa gjeneratave cilësore, ish-kapiten dhe lider i madh për Partizanin në disa sezone, ka punuar me trajnerët e mëdhenj të Partizanit, Lleshin, Shalësin dhe Grevën që në moshën 19 vjeçare, më 1972, me afrimin në skuadrën e parë. Lojtar sulmues dhe mbrojtës në të njëjtën kohë i shkëlqyer poshtë koshit, gjithmonë një ndër pikat më të forta të Partizanit në fushë, sidomos në luftën nën kosh. Simbol i numrit 15 në shpinë. Të panumërta ndeshjet e mëdha të tij, si në arenën kombëtare, me më shumë se 700 ndeshje në kupa e kampionate, por dhe në ndeshjet ndërkombëtare të shumta, ku vetëm në kupat e Europës numëron rreth 35 ndeshje. Ka zhvilluar ndeshje të mëdha ndaj ekipeve si Bentrash, Honved, BRNO, KK Bosna, Partizani Boegradit, Cantu, Eczacıbaşı, Vevey, Ortez. Një karrierë brilante sportive lidhur me klubin e basketbollit Partizani për plot 14 vite. Shumë ndeshje të mëdha në arenën ndërkombëtare me Partizanin, ku veçohet dueli i vjeshtës 1980 me Eczacıbaşı SK İstanbul, ku Mushi shënoi 44 pikë në 2 ballafaqimet, duke qenë lider i vërtetë në fushë. Po ashtu për t'u kujtuar ndeshja e tij e madhe ndaj Squibb Pallacanestro Cantù, më 4 nëntor 1981, ku së bashku me Çaçin e Kuqon i bën rezistencë të fortë Cantuse, një ndër ekipet më të forta të kontinentit, madje atë sezon kampion i Europës. Pra kemi të bëjmë me një basketbollist të përmasave europiane çka tregon se Partizani kishte realisht cilësi europiane, me individë si Kastriot Mushi, dhe brezi i artë i basketbollit të kuq, që diti të luante i barabartë në kupat europiane ndaj çdo ekipi. Pas lënies së basketbollit të luajtur, Kastrot Mushi ka qenë edhe trajner i të rinjve të Partizanit, ku arriti të dalë kampion, duke drejtuar si trajner fidanishten e Partizanit të basketbollit legjendar.

Dukuri të betejave të Skënderbeut



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTA

Beteja të rregullta të ushtrisë shqiptare


Lufta e rregullt në periudhën e ushtrisë së mesjetës kryhej nëpërmjet ndeshjes në fushë të hapur të masës kryesore të forcave të të dy palëve, të cilat ishin të rreshtuara përballë njëra-tjetrës ose e fillonin luftimin me afrimin në fushën e betejës. Të kësaj natyre janë një varg i tërë betejash të zhvilluara ndërmjet ushtrisë shqiptare, të udhëhequra nga Skënderbeu dhe ushtrisë osmane. Por beteja e Torviollit dhe e Albulenës kanë plotësisht tiparet e luftës së rregullt.

Në fushën e Torviollit, ku u zhvillua dhe beteja e parë në qershor të vitit 1444, ishin përballë njëra-tjetrës forcat osmane me një efektiv prej 25.000 këmbësorë e kalorës dhe shqiptare, 9.000 luftëtarë në fushë të hapur, si dhe 6.000 kalorës e këmbësorë të vendosur në mënyrë të fshehtë, në shpinë të rendimit luftarak. Pas luftimesh të ashpra të palëve, në një moment të vështirë Skënderbeu futi në luftim rezervën e maskuar, e cila përcaktoi dhe fatin e betejës, që përfundoi me shpartallimi e plotë të ushtrisë osmane.

Beteja e Torviollit e zhvilluar në fushë të hapur ku të dy palët ishin të rreshtuar përballë njëra-tjetrës, përbush të gjitha kriteret e një beteje sipas modeleve të luftës së rregullt. Beteja farkëtoi bashkimin luftarak të popullit shqiptar dhe forcoi simpatinë e besimin e tij te Skënderbeu. Beteja pati jehonë të madhe jashtë Shqipërisë dhe i bëri fuqitë europiane të drejtojnë vëmendjen e tyre nga Shqipëria.

Beteja në të cilën Skënderbeu shfaqti largpamësi, aftësi mahnitëse dhe nivel të lartë strategjik, ishte beteja e Albulenës e zhvilluar në verën e vitit 1457. Kjo ishte ndër betejat më të mëdha mësimëse të zhvilluara në fushat e Evropës gjatë shekujve XV-XVI.

Veprimet luftarake filluan me një tërheqje të thellë strategjike mashtruese të ushtrisë shqiptare, nga brezi kufitar në drejtim të Lezhës, për të krijuar te komanda osmane bindjen e gabuar se forcat shqiptare ishin të paorganizuara e të paaftha për të përballuar ushtrinë e tyre të madhe, që e detyroi Skënderbeun të kërkonte ndihmë te Venediku. Më pas vijoi një heshtje e plotë prej 4-5 javëve e forcave të Skënderbeut, që e bëri mashtrimin tërësisht të besueshëm. Në të tilla rrethana si vigjilenca e komandës, ashtu dhe disiplina e gatishmëria luftarake e forcave osmane të



përhapura në mënyrë të çrregullt në fushën e Albulenës, po shkonin drejt rënies. Shturja e disiplinës dhe vapa e madhe e gushtit e dobësuan aftësinë luftarake të ushtrisë osmane. Ideja e mashtrimit e Skënderbeut ishte realizuar me shumë sukses. Në momentin e përshtatshëm në mesditën e 7 shtatorit, luftëtarët e Skënderbeut kishin zënë në mënyrë të befasishme lartësitë në lindje të fushës së Albulenës, dhe kaluan në mësimje të vrullshme e të fuqishme duke e gjetur në befasi të plotë ushtrinë osmane. Humbjet e para për osmanët e tmerruar e në panik, ishin shumë të mëdha. Mbas përpjekjeve për t'u organizuar, luftimi mori tërësisht pamjen e betejës së rregullt, por zotërimin e gjendjes dhe epërsinë morale i kishin forcat shqiptare. Veç humbjeve të shumta që forcat osmane pësuan në fushën e betejës, grupime të çrregullta trupash asgjësoheshin nga pritja e ngritura në rrugët e tërheqjes. Fitorja ishte mahnitëse.

Metoda të luftës

Çështja e metodave të luftës së armatosur, të përdorur nga Skënderbeu në krye të një ushtrie të vogël kundër ushtrisë më të madhe e në mënyrë të fuqishme të kohës ka qenë e diskutuar nga studiues të huaj. Shumë prej tyre duke kërkuar shkakun e fitoreve, mundohen ta gjejnë atë në karakterin malor të vendit dhe në kështjellat e forta. Por në Ballkan ka vende me terren malor e të thyer por, pavarësisht qëndresës, nuk e përballuan dot furinë e sulmeve të ushtrisë osmane. Ndërmjet dy elementeve më kryesorë të luftimit njeriut dhe terrenit, shkak kryesor i fitores ishin njerëzit, shpirti i atdhedashurisë, heroizmit masiv dhe vendosmëria e tyre për të përballuar çdo sakrificë,

ishte forca dhe trimëria e tyre që siç e pohojnë vetë armiqët “si tigra kthetër-fortë dhe luftarakë, luftonin edhe me retë që kalonin sipër tyre”.

Historiani zviceran Schmid ka një tendencë të theksuar për të ulur vlerat e Skënderbeut e të veprës së tij, që e vlerësojnë Skënderbeun si një strateg vetëm të luftës guerile, si një komandant çetash të malësorëve. Natyrisht që Skënderbeu ishte një komandant shumë i zoti i luftës guerile, por ishte dhe strateg e komandant i zoti i luftës së rregullt. Analiza e luftërave dhe betejave të zhvilluara tregoi qartë se Skënderbeu, ishte njohës i thellë i artit ushtarak dhe kombinoi me mjeshtëri luftën e rregullt me luftën guerile.

Për t'u ndeshur me kundërshtarin i duheshin si metodat e luftës partizane, ashtu edhe beteja në fushë të hapur, për të ndëshkuar një ushtri të rregullt. Ushtria e Skënderbeut me mundësi mobilizimi të paktë në luftëtarë, duhej të ishte e aftë të përhapej me shpejtësi në fushën e luftës. Kjo ushtri përbëhej nga garda pretoriane, repartet e kufirit dhe forcat ndihmëse. Strategjia e Skënderbeut kishte vlerësuar drejt sasinë dhe cilësinë e ushtrisë në pikëpamje të cilësisë e morale dhe të aftësive taktike e profesionale. Në kompletimin e ushtrisë, Skënderbeu vendosi parimin “burrë për shtëpi” dhe hartoi listat e rekrutimit. Sistemi kishte tipare të shërbimit të detyrueshëm ushtarak, që ishte mjaft i përhapur në atë kohë. Ai jepte mundësi për realizimin me shpejtësi të mobilizimit të përgjithshëm të popullit në luftë. Skënderbeu, kështu krijoi i pari në Evropë në periudhën e mesjetës ushtrinë e përhershme dy vjet para Karlit XII në Francë, i cili, vetëm në vitin 1445 krijoi një lloj

ushtrie të përhershme.

Manovër strategjike

Fitorja e Albulenës ishte rrjedhojë e manovrës së thellë strategjike e cila bëri të mundur mashtrimin e armikut dhe nxjerrjen e forcave në kushte të përshtatshme, si në pikëpamje të terrenit, ashtu dhe të befasisë së goditjes. Kjo manovër me përmasa të mëdha dhe me një ide të qartë, nuk njihej atëherë jo vetëm nga ushtritë e vogla të vendeve të Europës, por edhe nga ushtria e madhe osmane. Kështu, ndërtimi i formacionit të luftimit, mënyra e zhvillimit të mësimjes dhe rezultatet që u arritën, i japin betejës së Albulenës tiparet e një beteje fushore të përmasave të mëdha, e të zhvilluara sipas të gjitha kërkesave të luftës së rregullt. Kjo betejë është një ndër betejat kulmore të historisë së luftërave që mund të arrihen nga strategë e komandantë të mëdhenj, me vizion e personalitet të veçantë e që gëzojnë adhurimin e besimin e plotë të ushtrisë. Ka historianë të cilët edhe pse i pranojnë përmasat e betejës së Albulenës, e vlerësojnë atë si një mësimje masive rezultative dhe mohojnë manovrën strategjike të ushtrisë shqiptare.

Albulena ishte fitorja më e madhe që kishte arritur ndonjëherë Skënderbeu në fushë të hapur. Fitorja në Albulenë pati pasojë tepër të rëndësishme. Sultan Mehmeti II u detyrua të bëjë përpjekje të shumta për të nënshkruar me Skënderbeun paqen. Në pamundësi të saj u detyrua që për disa vjet rresht të heqë dorë nga strategjia mësimëse dhe të kalojë në strategji mbrojtëse. Fitorja e ushtrisë shqiptare pati rëndësi të madhe edhe në planin ndërkombëtar. Me dështimin e përpjekjeve të Perandorisë Osmane për pushtimin e Shqipërisë,

dështoi në të njëjtën kohë edhe mundësia e zbatimit të planit strategjik të saj për pushtimin e Europës.

Aftësitë e shumanshme të Skënderbeut nxorën në dritë strategun me famë botërore dhe i dhanë mundësi atij të zhvillojë më tej artin ushtarak që arriti nivelin më të lartë të kohës. Duke përmendur artin ushtarak, Skënderbeu u mbështet në kushtet politike dhe social-ekonomike të Shqipërisë në atë kohë. I mbështetur në parime të shëndosha, arti ushtarak i Skënderbeut zgjidhi me sukses shumë detyra të ndërlikuara, si krijimi i Forcave të Armatosura, mobilizimi dhe përhapja e tyre për luftë, shfrytëzimi i terrenit dhe përgatitja fortifikuese e tij, organizimi dhe kryerja e zbulimit strategjik, caktimi i qëllimeve, formave e metodave për zhvillimin e fushatave e betejave, organizimi dhe kryerja e manovrës strategjike, krijimi i aleancave ushtarake, etj.

Manuale luftarake

Në mjaft vepra të autorëve europianë nën shembullin e betejave e të taktikës fitimtare të Skënderbeut iu kërkohehin sa më shpejt rrugët për dëbimin e osmanëve nga Europa. Taktikat e përdorura nga Skënderbeu në beteja u bënë si të thuash udhëzues për vendimmarrje të manualeve luftarake për burrat e shtetit, strategët dhe luftëtarët e tjerë. Pjetri i Madh urdhëronte përkthimin e librit “Mjelma” të shkrimtarit ukrainas J. Galatovski i shkruar nën shembullin e betejave fitimtare e të taktikës së Skënderbeut botuar në polonisht më 1679, të cilën e mbante vazhdimisht në bibliotekën e tij. Kollokotroni shkruan në kujtimet e tij, se historinë e Skënderbeut e mbante gjithmonë me vete, ndërsa njërit prej bastioneve të kalasë të Mesolongjit iu vu emri i Skënderbeut. Elisabeta do të shënonte me dorën e saj në “Luterusin” e saj më 17 janar 1659 në kujtim të vdekjes së Skënderbeut se këtë ditë vdiq princi i mirë Skënderbe, mbret i Epirit dhe ngadhënjimtar mbi osmanët.

Dëshmi e përhershme e vlerësimit dhe e respektit të thellë, që kanë popujt e tjerë për Skënderbeun, krahas botimeve për të, janë sheshet dhe rrugët e Romës, të Parisit, të Brukselit, të Gjenevës dhe të qyteteve të tjera të vendeve të ndryshme, ku janë vendosur buste e monumente dhe që mbajnë emrin “Gjergj Kastrioti - Skënderbeu”.

Figura madhështore e heroit Gjergj Kastrioti Skënderbeu është pasqyruar në një numër shumë të madh veprash të arteve figurave. Galeria Skënderbejane nis që nga vitet e para të shek. XVI e deri në ditët tona. Shumë autorë të Shqipërisë e të huaj kanë bërë portretin e kryetrimin plot adhurim e dashuri. Nuk dua të mbyll sytë pa parë malet e Shqipërisë, dëshmitarë të luftës së atij gjeniu luftëtar, do të shkruante me admirim Ernesto Sabato. ka qenë aty

